

Policia
Armë zyrtare
për qëllime
private!

Fq.5



**BANKA
BOTËRORE**
Maqedonia e
para me vdekjen
e fëmijëve!

Fq.7



**Për nëntë
muaj, 10
plaçkitje
me maska**

Fq.9



Koha

www.koha.mk

**Të bashkuar
drejt krizës**

Fq.14

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3465 · e premte, 21 shtator 2018

13°C | 29°C

15 DEN

EDITORIAL

**Manipulimi
mediatik, cilat
janë njohuritë
shkollore?**



Koncepti për shkollën si "magazinë e dijes" sot gjithkund në botë po braktiset dhe në vend të kësaj po promovohen forma të reja të mësim-nxënies, duke e bërë më funksionale lidhjen në mes të dijeve skolasitike dhe praktikës. Nevoja e... Fq.2

GLOBI

**Europa
po kthehet
djathtas**

Fq.15

SPECIALE

**Italia e
cigareve kon-
trabandë**

Fq.12

DOSSIER

**"Gjuha asht
tapia e vendit"**

Fq.17



THIRRJET PËR REFERENDUMIN PËRQENDROHEN BRENDA VENDIT

PRITJE TË VOGLA NGA DIASPORA

Interesimi i atyre që veprojnë dhe jetojnë jashtë vendit ka qenë shumë i vogël për t'u regjistruar si votues, ndërsa pritjet janë të vogla që mërgimtarët të vijnë ditën e votimit në referendum

Fq.4

S'ka dilema për censusin, por për fletët e votimit

Shkup, 20 shtator - Nuk kanë mbetur më shumë se 10 ditë nga data e zhvillimit të referendumit dhe Komisioni Shtetëror Zgjedhor nuk ka asnjë informacion se nga ku do të shpërndajë fletët e votimit dhe fletushkat e tjera shoqëruese tek Këshillat zgjedhorë lokalë. Edhe pse Klubi i deputetëve është një prej destinacioneve të mundshme, nga Qeveria nuk kanë dhënë asnjë lajmërim lidhur me këtë çështje. Madje, sipas

KSHZ-së, është hera e tretë që të enjten ata i drejtohen me kërkesë Qeverisë që të mundësojë tërheqjen e materialeve zgjedhore nga Klubi i deputetëve. Për momentin, nga ky institucion pohojnë se kanë edhe një opsion tjetër që fletët e votimit dhe materialet e tjera të tërhiqen nga zyrat e KSHZ. "Do të ishte më mirë që shpërndarja të bëhej nga Klubi i deputetëve pasi atje ka më shumë..." Fq.3



EDITORIAL

MANIPULIMI MEDIATIK, CILAT JANË NJOHURITË SHKOLLORE?



Emin AZEMI

Koncepti për shkollën si "magazinë e dijës" sot gjithkund në botë po braktiset dhe në vend të kësaj po promovohen forma të reja të mësim-nxënies, duke e bërë më funksionale lidhjen në mes të dijeve skolare dhe praktikës. Nevoja e përfshirjes së Edukimit mediatic, si lëndë e obligueshme në kuadër të planprogrameve të reja mësimore, nuk do të duhej të ishte vetëm një projekt ligjor, ende i munguar, por edhe domosdoshmëri që nxënësit e sotëm, të cilët nesër do të jenë qytetarë të denjë me obligime e përgjegjësi shoqërore, të arrijnë të identifikojnë manipulimin mediatic dhe në mënyrë autonome të ndërtojnë qëndrime e pikëpamje pa qenë të ndikuar domosdoshmërisht nga mediat.

Një Ligj që do të rregullonte sferën e përdorimit të mediave, do të ishte më se i nevojshëm edhe për faktin se shoqëritë e zhvilluara nuk ua lënë individëve që në mënyrë pavarur dhe josistematike të merren me përvetësimin dhe avancimin e shkathtësive për të analizuar efekteve që kanë mediat në jetën tonë të përditshme. Ky, mbi të gjitha është obligim institucional e kompetent që rregullon në mënyrë të drejtë e profesionale të kontestit shoqëror, teknologjik, argëtues, informues të mediave në jetën e njeriut, sidomos të moshave më të reja.

Sfidat që po vijnë si rezultat i përparimit teknologjik, nuk kanë lënë pa prekur edhe arsimin, kurse më të goditurit ndaj këtyre sfidave janë nxënësit. Interneti sot është bërë vegla e kudondodhur dhe tundimi që prodhon ai është i papërbalueshëm, nëse nuk krijohen paraprakisht mekanizma që do ta zbutnin shkallën e ndikimit pa kriter të nusuprodukteve që nxjerr interneti (rrjetet sociale, reklamat, blogjet etj.)

Sikundër dihet, Edukimi mediatic nxit dhe zhvillon disa shkathtësi: teknike (aftëson qasjen ndaj mediave), kritike (të kuptuarit e përmbajtjeve mediaticke, të aftësuarit e interpretimit të tyre dhe vlerësimin kritik) dhe praktike (aftësia e të kuptuarit të porosive mediaticke).

Ndërkaq, objekt shqyrtimi i edukimit mediatic do të ishin: përmbajtjet e dëmshme mediaticke (dhuna, reklamat, pornografia), ndikimi i mediave dhe përmbajtjet e dëmshme, rregullimi dhe vetërregullimi (konventat, kornizat ligjore dhe kodet etike gazetareske dhe reklamuesit), pastaj teknologjitë e reja dhe roli i tyre shoqëror, industrializimi i informacionit, kultura dhe argëtimi, komunikimi interaktiv, zhanret e reja mediaticke, siç është blogu etj. Edukimi mediatic ishte definuar si nocion dhe si përmbajtje qysh në Konferencën ndërkombëtare (National Leadership Conference on Media Literacy, 1992) që nënkuptonte "aftësinë e qasjes, analizës, vlerësimit dhe transmetimit të porosive përmes mediave". Nëse i bëjmë një interpretim të lirë fushëveprimi që do të kapte Edukimi mediatic, të pashmangshme do të ishin temat që kanë të bëjnë me përvetësimin e shkathtësive kreative dhe kritike, gjegjësisht dijeve që ndihmojnë lidhshmërinë e ideve komplekse, si dhe identifikimi i dilemave që janë në themelet e lirive njerëzore e intelektuale. Ky përkufizim mbi edukimin mediatic nuk lë mangut edhe komponentën mjaft të rëndësishme që kanë mediat si burim informacioni e argëtimi, për të cilat duhet patur njohuri e shkathtësi.

UNESCO, madje, qysh në vitet shtatëdhjetë të shekullit të kaluar kishte inicuar idenë e edukimit mediatic. Duke e bazuar idenë në rëndësinë që kanë mediat në jetën e individit dhe të familjes, ishte kërkuar që në nivele ndërkombëtare të mblidhen studiues për të shqyrtuar mundësinë e përfshirjes së edukimit mediatic në sistemin arsimor në të gjitha shtetet e zhvilluara dhe më pak të zhvilluara. Për rrjedhojë, ishte nënshkruar edhe Deklarata mbi edukimin mediatic (Declaration of Media Education) në vitin 1982, ndonëse që nga nënshkrimi i kësaj Deklarate e deri më sot koncepti mbi edukimin mediatic deri-diku ka ndryshuar, varësisht prej sfidave dhe konteksteve nëpër të cilat kalojnë shoqëritë. Maqedonia, gjithsesi, nuk është immune ndaj këtyre sfidave, kurse Ligji për edukimin mediatic do të ishte mjet parandalues i devijimeve që prodhon xhungla e pakrasitur e internetit dhe mediave të reja.

"TËRME" TË FUQISHME NË BOTËN ORTHODOKSE!

"Pas insistimit të Patrikanës së Ukrainës që të ndahet nga Kisha Orthodokse Ruse, në botën orthodokse ka zënë fill edhe një ndarje e re që do të jetë shumë e dhimbshme për orthodoksët. Patrikana e Ukrainës në prill të këtij viti i ka shkruar letër Patrikanës së Stambollit, dhe ka kërkuar nga ajo ndihmë dhe mbështetje për tu ndarë nga Kisha Orthodokse Ruse. Sipas rregullave të botës orthodokse, për tu ndarë një Patrikanë nga Kisha Orthodokse, asaj i nevojitet ndihma e gjysmës së botës orthodokse. Siç dihet, në botë llogaritet se jetojnë diku afër 260 milion orthodoks. Ajo që jo të gjithë e dinë është fakti se rregullimi "administrativ" i botës orthodokse nuk është sikur i botës katolike që ka qendrën në Vatikan, apo si bota islame që dikur kishte halifatin. Zona të ndryshme gjeografike kanë kishat dhe patrikanet thuhet të pavarura, por që, disa nga ato janë më të njohura se të tjerat, pikërisht për shkak të rolit të tyre në historinë e krishterimit. Patrikana e Stambollit që është ekumenike, është më e njohura në botë. Andaj, shumë njerëz mendojnë se Stambolli është qendra e botës orthodokse dhe se Patrikana e Konstantinopojës është "halifati" orthodoks i botës. E kjo nuk është e vërtete.

Çështja e vërteta, gjysma e orthodoksëve që jetojnë në botë sot jetojnë në Rusi. Pason Ukraina, Bellorusia, vendet Ballkanike dhe të tjerët të shpërndarë nëpër botë. Pas rënies së Bizantit dhe pasi Moskë shpallë veten për Roma e III-të, natyrisht, meqë një numër i madh i orthodoksëve jetojnë në Rusi dhe se ajo përgjatë historisë kishte luajtur një rol relativisht determinues në arenën ndërkombëtare, bënë që Rusia të njihet si të ishte kryeqendra e botës krishtere orthodokse. Edhe pse në fakt pati refleksione të këtyra, Kisha Orthodokse Ruse (Patrikana e Moskës) rradhitet vetëm në pozitën e pestë nëpër lutjet (duatë) zyrtare të ritualeve orthodokse. E para që përmendet në ato lutje është Patrikana e Stambollit, e dyta është Patrikana e Aleksandrisë në Egjipt, e treta Patrikana e Antakisë në Turqi dhe e katërta është Patrikana Orthodokse në Kudsi Sherif (Jerusalem). Nga ana tjetër, kishat orthodokse që janë në Kosovë, edhe pse ato janë të Kosovës dhe u përkasin para së gjithash shqiptarëve, e jo serbëve, për shkak të politikave shoveniste serbe mbi shqiptarët e sidomos për shkak të injorancës dhe naivitetit politik të klasës politike shqiptare, ato kisha i ka marrë nën kontroll dhe i menaxhon edhe fetarisht Kisha Orthodokse Pravosllave Serbe. Ndër detyrat me rëndësi që do të duhej t'i kryente shkenca e historisë shqiptare, është të gjejë materiale arkivore të nevojshme rreth ndërtimit dhe historisë së atyre kishave dhe një ditë, kur është e mundur të bisedohet me insistim dhe me interes për shqiptarët, ato materiale tua qet mbi tavolinë klasës politike shqiptare. Sidomos asaj në Kosovë...!", ka shkruar në profilin e tij e Facebook, prof. Mustafa Bajrami.

MEDIA Citate

TRUMP PROPOZON NDËRTIMIN E NJË MURI NË SAHARA

Presidenti amerikan Donald Trump ka sugjeruar ndërtimin e një muri përgjatë Saharës për të trajtuar krizën e emigrantëve në Evropë, ka pohuar ministri i jashtëm spanjoll.

Josep Borrell tha se Presidenti i SHBA kishte insistuar që pengesa që ka premtuar të ndërtojë përgjatë kufirit midis Amerikës dhe Meksikës, të funksiononte edhe për Evropën. Spanja është bërë një pikë kyçe për hyrjen masive të emigrantëve që vijnë nga Afrika Veriore. Shumë nga refugjatët janë nga vendet sub-Sahariane. Ish-Presidenti i Parlamentit Evropian nuk zbuloi se kur ishte bërë propozimi radikal nga Trump.

Por burimet diplomatike sugjeruan se propozimi ishte bërë në qershor, kur ai fluturoi në Shtetet e Bashkuara, udhëtim që përkoi me vizitën në Shtëpinë e Bardhë të mbretit dhe mbretëreshës spanjolle.

(The Telegraph, 20 shtator)

BESYNON LUFTIMIN E TRAFIKIMIT TË MIGRANTËVE

Liderët e Bashkimit Evropian kanë bërë thirrje për bisedime më intensive me Egjiptin dhe shtetet tjera të Afrikës Veriore, ashtu që të marrin hapa tjerë kundër migrimin ilegal në Evropë, sidomos duke luftuar ata që i trafikojnë emigrantët.

Kancelari i Austrisë, Sebastian Kurz ka thënë se liderët kanë përkrahur këtë ide në qytetin e Austrisë, Salsburg, duke thënë se të paktën Egjipti, "është i gatshëm për të shtuar bisedimet me Bashkimin Evropian".

"Unë mendoj se ky do të jetë hap i rëndësishëm në luftimin e migrimin ilegal, mirëpo përveç tjerash edhe për t'u përballur me biznesin e trafikimit", ka thënë Kurz para gazetarëve. Ministria e Jashtme e Egjiptit ka konfirmuar të enjten se ka propozuar mbajtjen e një samiti të përbashkët me liderët e BE-së dhe ata të vendeve arabe, për të diskutuar një varg çështjesh, duke përfshirë migrimin. Sipas burimeve të BE-së, samiti mund të mbahet në muajin shkurt.

(REL, 20 shtator)

NËSE NUK E KENI DITUR...

ÇFARË ËSHTË "KRONIKA E JANINËS"?

"Kronika e Janinës" është kronikë anonime e shkruar në fillim të shek.XV. Përshkruan ngjarjet politike-ushtarake që u zhvilluan në Epir, Akarnani dhe në Etole në gjysmën e dytë të shek.XIV. Një vend me rëndësi zënë midis tyre njoftimet mbi shtrirjen dhe veprimtarinë e shqiptarëve në këto treva gjatë 30-40 viteve të fundit të shek.XIV. Të tilla janë të dhënat

për betejën e Akelout midis shqiptarëve e bizantinëve (1358), mbi krijimin e despotatit shqiptar të Artës dhe konfliktet e shqiptarëve të udhëhequr nga Gjin Bue Shpata me despotin serb të Janinës Th. Preluboviç dhe pasardhësin e tij Isau Buondelmonte dhe më në fund mbi luftërat e para të shqiptarëve me osmanët në këtë trevë.

QEVERIA NË DILEMË 10 DITË PËRPARA REFERENDUMIT

KSHZ S'KA DILEMA PËR CENSUSIN, POR PËR FLETËT E VOTIMIT

Zgjedhja e vendit është një prej problemeve të vetme që ka për momentin KSHZ, pasi sipas tyre, faza përgatitore po zhvillohet normalisht. Nga KSHZ kanë bërë po ashtu me dije edhe dy kushtet e domosdoshme që duhet të plotësohen për të pasur referendum të suksesshëm: gjysma e votuesve të regjistruar plus një të dalë në votim dhe gjysma e votuesve plus një të votojnë "për"

Koha **Evis HALILI**

Shkup, 20 shtator - Nuk kanë mbetur më shumë se 10 ditë nga data e zhvillimit të referendumit dhe Komisioni Shtetëror Zgjedhor nuk ka asnjë informacion se nga ku do të shpërndajë fletët e votimit dhe fletushkat e tjera shoqëruese tek Këshillat zgjedhorë lokalë. Edhe pse Klubi i deputetëve është një prej destinacioneve të mundshme, nga Qeveria nuk kanë dhënë asnjë lajmërim lidhur me këtë çështje. Madje, sipas KSHZ-së, është hera e tretë që të enjten ata i drejtohen me kërkesë Qeverisë që të mundë-



sojë tërheqjen e materialeve zgjedhore nga Klubi i deputetëve. Për momentin, nga ky institucion pohojnë se kanë edhe një opsion tjetër që fletët e votimit dhe materialet e tjera të tërhiqen nga zyrat e KSHZ.

"Do të ishte më mirë që shpërndarja të bëhej nga Klubi i deputetëve pasi atje ka më shumë hapësirë, akses është më i mirë dhe vetë procesi do të funksiononte me më shumë lehtësi. Duke u nisur nga zgjedhjet e fundit ku ky ambient ishte shumë funksional kemi kërkuar nga Qeveria që sërish të bëjë të njëjtën zgjedhje", thonë nga KSHZ. Zgjedhja e vendit është një prej problemeve të vetme që ka për momentin KSHZ, pasi sipas tyre faza përgatitore po zhvillohet normalisht. Nga KSHZ kanë bërë po ashtu me dije edhe dy kushtet e domosdoshme që duhet të plotë-

sohen për të pasur referendum të suksesshëm. Që gjysma e votuesve të regjistruar plus (prej 1.806.336 votuesve të regjistruar të dalin 903.169 votues) një të dalë në votim dhe gjysma e votuesve plus një (451.585 votues) të votojnë "për". Ata kanë sqaruar se kushtet të cilat duhet të plotësohen janë të ndryshme, në rastet kur referendum është obligues dhe se për çfarë nënshkruhet. Kur bëhet fjalë për referendum të domosdoshëm dhe jo konsultativ nevojitet shumicë absolute, 50 për qind plus 1 nga votuesit duhet të jenë "për".

Një referendum i tillë pritet të jetë ai që mund të organizohet pas përfundimit të negociatave për anëtarësimin në Bashkimin Evropian dhe ku qytetarët do të duhet të votojnë në një referendum të domosdoshëm. Dilemën lidhur me censusin që duhet të plotësohet që

referendumi të jetë i suksesshëm e hapën gjykatësit e Kushtetueses, një pjesë e të cilëve ishin të mendimit se për referendum të suksesshëm nevojitet shumicë absolute, ndërsa të tjerët ishin në një linjë me KSHZ. Kjo e fundit pret që në të ardhmen të harmonizohen Ligji për referendumin dhe Kodin Zgjedhor. Një prej risive që paralajmërohet për referendumin është se informimi nga ky institucion lidhur me përqindjen e daljes së votuesve do të bëhet gjashtë herë në ditë dhe jo tre herë si në zgjedhjet e mëparshme, ndërsa heshtja zgjedhore filon 48 orë përpara referendumit, pra më 27 shtator. Ndërsa sa i takon ankesave, qytetarët mund t'i drejtohen linjës telefonike pa pagesë (0800 555 44) që ka një kapacitet për pranimin e dhjetë ankesave njëkohësisht, e të cilat KSHZ do t'i publikojë në faqen zyrtare.



Thaçi takoi Thaçin dhe Veselin

Prishtinë, 20 shtator - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, dhe në Prishtinë e priti në takim pune kryetarin e Partisë Demokratike Shqiptare, Menduh Thaçi. Në takim, siç njofton Shërbimi për Informim i PDSH-së, u bisedua për situatën aktuale politike në rajon, për integrimet euroatlantike, si dhe për referendumin në Maqedoni. Bashkëbiseduesit, shtohet më tej, u pajtuan se shqiptarët, kudo që janë, duhet të jenë të bashkuar dhe të përkushtuar për çdo zgjidhje në kuadër të vlerave perëndimore. "Përkrahja për referendumin në Maqedoni dhe për dialogun ndërmjet Kosovës e Serbisë është një përcaktim i qartë për të ardhmen evropiane të shqiptarëve dhe gjithë popujve të rajonit tonë", thuhet në kumtesë. Thaçi gjatë vizitës zyrtare në Prishtinë zhvilloi takim edhe me kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, me ç'rast u bisedua për integrimet euroatlantike të rajonit, si dhe për referendumin në Maqedoni. Bashkëbiseduesit, thuhet në kumtesën e PDSH-së, gjatë takimit vlerësuan se dalja masive në referendum dhe vota PËR do të mundësonte integrimin e Maqedonisë në NATO dhe BE, ku edhe shqiptarët do të bashkoheshin në sistemin e vlerave perëndimore, si dhe do të sillte stabilitet, paqe, zhvillim ekonomik dhe forcim të demokracisë.

Papadimuilis i sigurt se Parlamenti grek e ratifikon Marrëveshjen

Shkup, 20 shtator - Jam i sigurt se do të ketë shumicë në Parlamentin grek që do të votojë për Marrëveshjen e Prespës, deklaroi nënkryetari i Parlamentit Evropian dhe shef i eurogrupit të Syrizes, Dimitris Papadimuilis, në

konferencën për shtyp pas përfundimit të Komitetit të përzier parlamentar MK-BE në Parlamentin e Maqedonisë. "Nuk kam kurrfarë dyshimesh, jam i sigurt, nëse shteti juaj e ratifikon Marrëveshjen e Prespës dhe për atë i bën të gjitha

ndryshimet e nevojshme kushtetuese siç u dakorduam, atëherë Parlamenti grek do ta ratifikojë marrëveshjen", tha Papadimuilis. Ai potencoi se pret që Marrëveshja e Prespës të ratifikohet nga ana e Parlamentit grek në mars të

vitet të ardhshëm. Komiteti i përzier parlamentar MK-BE e mbajti mbledhjen e tij të 15-të nën kryesim të përbashkët të Alojz Peterle, eurodeputet nga Sllovenia dhe Goran Milevski, deputet dhe kryetar i LDP-së.

FON DER LAIN ME POROSI NGA SHKUPI



Shkup, 20 shtator - Dëshirojmë ta ndërtojmë Evropën së bashku me ju. Jam e bindur se referendumi do të jetë i suksesshëm dhe se në fund do të ecni në rrugën e drejtë, deklaroi ministrja gjermane

E keni shansin unik, shfrytëzojeni

ne e Mbrojtjes, Ursula fon der Lain në konferencën e djeshme të përbashkët në Ministrinë e Mbrojtjes së Maqedonisë me homologen e saj të Maqedonisë, Radmilla Shekerinska. "Ju pret referendum. E di se ai lidhet me emrin e shtetit tuaj, identitetin dhe historinë tuaj, por megjithatë këtë referendum e shoh si shans të madh. Besoj se qytetarët e vendit tuaj do të marrin pjesë në mënyrë aktive. Nga përvoja jonë lidhur me bashkimin e Gjermanisë mund të them se

shanset e tilla janë unike dhe se duhet shfrytëzuar. Edhe kur flas për shfrytëzimin e shansit dua të them se flas për Evropën e bashkuar, se dëshirojmë së bashku të vazhdojmë ta ndërtojmë Evropën me ju", tha ministrja Fon der Lain. Sipas ministres gjermane të Mbrojtjes, kur bëhet fjalë për bashkëpunimin bilateral, dëshiron së bashku të hapë rrugën drejt anëtarësimit në NATO. "Do të vazhdojmë të bashkëpunojmë në nivel bilateral lidhur me stërvitjet

e përbashkëta të cilat mund të zbatohen në bashkëpunim midis dy shteteve. Ofrojmë mundësi për thellimin e bashkëpunimit në sferën e trajnimit të kualifikimit të mëtejshëm, por nënkuptohet edhe në planin material. Kur flasim për NATO-n mund të them se mendimet tona janë shumë të ngjashme dhe shumë të afërta por e kam ndjesinë sikur ju të jeni pjesë e NATO-s. Tani bëhet fjalë praktikisht për një kalim, ndërsa ai është të bëheni anëtare e NATO-s. Jam e

bindur se referendumi do të jetë i suksesshëm, se gjithçka do të jetë siç duhet dhe se në fund do të ecni nëpër rrugën e drejtë", tha ministrja gjermane e Mbrojtjes, Fon der Lain. Ministrja Shekerinska duke iu përgjigjur pyetjes së gazetarëve se çfarë nëse referendumi nuk ka sukses dhe nëse Maqedonia do të mbetet para dyerve të NATO-s, shprehu bindjen se referendumi do të jetë i suksesshëm dhe se vendi do të përgatitet për bisedat inkadruese me NATO-n.

THIRRJET PËR REFERENDUMIN PËRQENDROHEN BRENDIA VENDIT

PRITJE TË VOGLA NGA DIASPORA

Interesimi i atyre që vepronë dhe jetojnë jashtë vendit ka qenë shumë i vogël për t'u regjistruar si votues, ndërsa pritjet janë të vogla që mërgimtarët të vijnë ditën e votimit në referendum

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 20 shtator - Atmosfera politike këto ditë është e ngarkuar me vizita të shumta jo vetëm të diplomatëve të nivelit më të lartë, siç ishte sekretari amerikan i mbrojtjes Matis, por edhe diplomatët të nivelit më të ulët. Formalisht vizita e këtyre të fundit tyre arsyetohet përmes debateve në Konferenca të ndryshme dhe tryezave të rrumbullakëta, por se qëllimi është përgatitja e operative për suksesin referendumi. Kjo, pasi tashmë hapur flitet për tendencat e Rusisë për të ndikuar në mos suksesin referendumi, nga diplomatët të lartë të SHBA dhe nga vetë Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg. Pikërisht frika nga Rusia ditëve të fundit ka zhvendosur debatin mbi referendumin nga brenda vendit në arenën ndërkombëtare. Jo rastësisht, në prag të referendumi kryeministri Zoran Zaev është ftuar për vizitë zyrtare në SHBA nga zëvendëspresidenti amerikan Majk Pens. Nga ana tjetër, referendumi në Maqedoni është në fokus të mediave me prestigjioze ndërkombëtare, kjo për shkak të interesave gjeostrategjike të vendeve më të zhvilluara perëndimore nga njëra anë dhe Rusisë nga ana tjetër. Kur kësaj i shtojmë edhe bojkotin e heshtur nga strukturat partiake të VMRO-së, si dhe numrin e madh të qytetarëve jashtë vendit, ekziston frikë reale për arritjen ose jo të censusit elektoral prej 50+1%.

VOTA PRO E GARANTUAR

Bile, interesimi i atyre që vepronë dhe jetojnë jashtë vendit ka qenë shumë i vogël për t'u regjistruar si votues, ndërsa pritjet janë të vogla që mërgimtarët të vijnë ditën e votimit në referendum. Por se për dallim nga zgjedhjet lokale dhe parlamentare, kësaj radhe nuk ka shenja se mërgimtarët sidomos ato shqiptare do të vijnë në masë të konsiderueshme për të votuar në referendum. Që të ketë sukses referendumi, duhet që përveç se të dalin në votim mbi 50+1%, duhet që gjysma e tyre të votojnë pro. Apo llogaritur në numra, lista zgjedhore ka 1.806.336, qytetarë me të



KURC SËRISH FTON TË VOTOHET REFERENDUMI

Kancelari austriak Sebastijan Kurc dje përmes një video porosie sërisht u bëri thirrje qytetarëve të Maqedonisë që të dalin në votim në referendumin më 30 shtator. "Austria është mike dhe partnere e rëndësishme e Maqedonisë. Shpresoj në rezultat pozitiv nga referendumi, në pjesëmarrje aktive nga qytetarët dhe me këtë, zgjidhje të perspektivës evropiane. Unë nuk mund ta sjell vendimin tuaj,



por si mike e Maqedonisë shpresoj në vendim të duhur dhe në zhvillim evropian", porositi Kurc. Kancelari austriak të njëjtën porosi e drejtori edhe gjatë vizitës në Maqedoni më 7 shtator. Ai e përshëndeti marrëveshjen e arritur me Greqinë, ndërsa pranimit i saj në referendum, siç theksoi, është një shans i madh për europerspektivat e Maqedonisë dhe për tërë rajonin.

drejtë vote, censusi arrihet me 903.169 votues, dhe që të jetë i suksesshëm - duhet të votojnë pro 451.585 qytetarë. Kur jemi tek vizitat e funksionarëve të BE-së dhe vendeve tjera, së fundmi në Maqedoni kanë ardhur disa nga eurodeputetët më me zë të Parlamentit Evropian të njohur për lobimin pro Maqedonisë dhe kontribues të mëhershëm në lidhjen e Marrëveshjes e Përzihnos si Eduard Kukan, Knut Franke-shtejn, Ivo Vajgël, Eduard Peterle, dhe të tjerë. Është gjetur koha gjatë fushatës për referendumin për të mbajtur takimin 15 në kuadër të Komitetit të përzier parlamentar, Republika e Maqedonisë dhe Bashkimi Evropian. Në hapjen e seancës së parë, eurodeputetët të cilët u adresuan para pjesëmarrësve në këtë takim përshëndetën progresin e Maqedonisë në rrugën e saj drejt NATO-s dhe BE-së, në veçanti marrëveshjen e arritur me Bullgarinë dhe Greqinë, të cilat i vlerësuan si hapa të rëndësishme drejt qëllimeve strategjike të vendit. Eurode-

puteti dhe bashkëkryesuesi i KPP-Maqedoni dhe BE-së, Alojz Peterle, në hapjen e seancës bëri të ditur se sot në Shkup ka takuar palët e pozitës dhe opozitës, të cilët siç tha ai, kanë ndarë ambicie të njëjta për anëtarësimin e vendit në NATO dhe BE. "Këto ditë, ju patë shumë vizitorë këtu dhe ne nuk i konsiderojmë ato si presion, por pak a shumë si shenjë vëmendjeje dhe pritje për lëvizjen e vendit. Ne do të ndjekim atë që qytetarët do të vendosin. Kjo është një pozitë demokratike dhe varet nga qytetarët nëse do të shfrytëzojnë mundësinë ose do të presin për një tjetër", tha Peterle, duke iu referuar referendumin të 30 shtatorit që do të mbahet në Maqedoni.

VMRO-DPMNE ZBUT QËNDRIMET

"Nëse referendumi do të jetë i suksesshëm dhe shumica do të votojnë në drejtim për përkrahje të referendumi, situata mbetet e qartë dhe VMRO-DPMNE do ta respektojë këtë", kështu deklaroi lide-

ri partisë opozitare, Hristian Mickovski në debatin Click Plus të Televizionit 21, i pyetur nëse referendumi kalon me sukses, a do t'ju thuash deputetëve t'i përkrahin ndryshimet kushtetuese për të cilat nevojitet dy e treta e shumicës në Kuvend. Në lidhje me qëndrimin e tij për referendumin, ai e përsëriti qëndrimin partiak se secili duhet të vendosë sipas bindjeve personale, duke shtuar se VMRO-DPMNE është për integrim në Bashkimin Evropian (BE), por është kundër Marrëveshjes për emrin me Greqinë. Përveç anëtarëve të Kryesisë partiake që kanë thënë se nuk do të dalin në referendum, së fundmi kanë dalë zëra të theksuar për të dalë në referendum. Kostandin Bogdanov, anëtarë i Komitetit Ekzekutiv i VMRO-DPMNE-së, në intervistë për "Faktor" thotë se do të votojë në referendum.


"Unë që në takimin e Komitetit Ekzekutiv e kam deklaruar qëndrimin tim se partia duhet që t'i ftojë anëtarët masivisht të votojnë në re-

ferendum dhe të votojnë në pajtueshmëri me bindjen e tyre 'për' ose 'kundër' Marrëveshjes. Unë personalisht do të dal të votoj", thotë Bogdanov. Sipas tij, duhet që ta kemi parasysh rëndësinë historike të këtij referendumi, dhe padyshim se hap perspektivë të re për të gjithë ne që jetojmë këtu. "Ngelen edhe dhjetëra ditë, porositë e miqve tanë dhe partive simotër i dëgjuam. I dëgjuam edhe argumentet kundër Marrëveshjes. Për fat të keq, ende dikush nuk ka arritur që të ofrojë alternativë serioze dhe reale për vetë Marrëveshje, por as që ka arritur që të ofrojë alternativë përkatëse të anëtarësim në BE dhe NATO. Nëse ngelet kështu edhe në periudhën në vijim, thjeshtë nuk do të ketë opsion përveç që të përkrahët Marrëveshje me të gjitha koncesionet e bëra nga ana e Maqedonisë", thotë ai. Ndryshe deri më tani dhjetëra deputetë të VMRO-DPMNE-së në profilet e tyre zyrtare në rrjetin social Facebook janë deklaruar se nuk do të votojnë për ndryshimet kushtetuese që parashihen me Marrëveshjen me Greqinë dhe ndryshim të emrit të shtetit në Republika e Maqedonisë së Veriut. Nuk është e qartë pse kështu deputetët e VMRO-DPMNE-së kanë filluar të tregojnë qëndrimet në lidhje me ndryshimet kushtetuese në Maqedonisë. Nëpërmjet Facebook-ut, deri më tani deklarata të tilla kanë publikuar Dafina Stojanovska, Zoran Iloski, Eilija Aleksandrova, Dimitar Stevanxhija, Ane Lashkoska, Pavlinka Čestojnova, Nikolla Micevski, Magdalena Manaskova, Trajçe Dimkov, Liljana Zaturaska, Liljana Kuzmanovska, Vasil Pishev, Vlatko Gjočev. VMRO-DPMNE dhe koalicioni kanë 48 deputetë. Nga koalicioni disa deputetë të partive tjera janë deklaruar se i përkrahin politikat e shumicës në Kuvend (Pančo Minov, Stojan illanov, Lupčo Dimovski, Vlladanka Aviroviq, Zekir Ramçillov, Amdin Bajram, Čedomir Sazdovski dhe Jusuf Hasani).

Tanimë gjatë kohë spekulohet se 11 deputetë të VMRO-DPMNE-së në dhjetor do të votojnë "për" ndryshimet kushtetuese. Për ndryshim të Kushtetutës janë të nevojshme 2/3 e numrit të përgjithshëm të deputetëve, gjegjësisht 81 vota. "Nuk do të votojnë për ndryshimin e emrit kushtetues të Republikës së Maqedonisë", ka shkruar Vlladimir Gjočev, deputeti i VMRO-DPMNE-së, në profilin e tij në Facebook. "Maqedonia është ideali im dhe dashuri e përjetshme. Ajo është emocion dhe kauzë që nuk kalon. Qëndrimi i popullit dhe votuesve është i qartë, janë kundër ndryshimeve kushtetuese për ndërrimin e emrit kushtetues të Republikës së Maqedonisë", ka shkruar Gjočev.

AHMETI TAKOI ROBERTSONIN

Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim, Ali Ahmeti, është takuar në Shkup me ish Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s dhe ish Ministrin Britanik të Mbrojtjes, Lordin Xhorxh Robertson dhe komandantin e forcave të NATO-s në vitin 2001 në Maqedoni, Gjeneralin Ser Barni Uajt-Spuner. Z. Ahmeti shprehu mirënjohje për kontributin e jashtëzakontë të Lordit Robertson dhe Gjeneralin Barni në arritjen në prag të anëtarësimin në NATO dhe fillimit të negociatave me Bashkimin Evropian. "Ahmeti dhe Lordi



Robertson u dakorduan që vendimi i 30 shtatorit është historik dhe shansi i gjeneratës tonë për ta siguruar të ardhmen e rinisë është tani ose kurrë. Ne jemi të përkushtuar për sukses sepse integrimi i Maqedonisë në strukturat euroatlantike është prioritet absolut i të gjithë qytetarëve të vendit tonë dhe sjell paqe, siguri e stabilitet, por edhe zhvillim ekonomik. Bashkëbiseduesit diskutuan edhe mbi zhvillimet rajonale, me theks të veçantë mbi dialogun Prishtinë-Beograd", thuhet në komunikatën e BDI-së.

Vërejtjet më të mëdha të viteve të fundit si nga Avokati i Popullit, por në përgjithësi nga opinioni kanë qenë se Sektori për Kontroll të Brendshëm në MPB nuk e kryen punën e tij si duhet. Toleranca apo heshtja ndaj reagimeve të qytetarëve për punën e policisë shpesh herë kanë rezultuar me pasoja të rënda

PËRFSHIRJA E POLICËVE NË INCIDENTE

ARMË ZYRTARE PËR QËLLIME PRIVATE!



Koha Omer XHAFERI

Shkup, 20 shtator - Ditë më parë, një polic nga Manastiri kishte vra, dhe pastaj djegur kufomën e një bashkëqytetari i tij. Krimin ai e kishte kryer me armë zyrtare, kurse si nëpunës policie ai e ka keqpërdorur pozitën zyrtare për qerim privat të hesapeve. Siç ka raportuar edhe gazeta jonë, kjo ngjarje ka tronditur banorët lokalë për faktin se ara ndjehen të pasigurt në raport me sjelljet e policëve të cilët jo rrallë dinë të shkelin kodeksin e tyre profesional.

Në anën tjetër, edhe krismat me armë zyrtare në dasma dhe ahengje të ndryshme familjare, paraqesin një sekret publike, por që vazhdimisht anashkalohe nga organet e rendit të cilët mjaftohen vetëm me apele që këto evente të kalojnë në qetësinë maksimale. Gjatë këtij viti, MPB po ashtu njoftoi se disa pjesëtarë të njësitit ALFA e kanë keqpërdorur autoritetin e tyre zyrtar për zgjidhjen e problemeve familjare. Profesori i sociologjisë, Hasan Jashari, duke i komentuar rastet e tilla thekson

se keqpërdorimi i autoritet policor në vendin tonë parqet një problem mjaftë delikat.

"Përderisa në shoqërinë tonë ka raste kur në mitingje zgjedhore festohet me automatik, në prani të ministrave dhe deputetëve, atëherë nuk duhet të presim shumë edhe nga administratorët apo nëpunësit e vegjël të MPB-së. Në këtë rast ne si shoqëri ballafaqohemi me një patologji sociale, e cila burimin e ka prej lartë, prej strukturrave më të larta qeveritare, të cilët gjatë festimeve të tyre përdorin armatimin dhe nuk ndëshkohen. Iluzion do të ishte nëse ne presim disiplinë të zyrtarët e policisë, kur ajo mungon te eprorët e tyre", thotë sociologu Jashari. Procesi i seleksionimit të policive të ri sipas tij nuk duhet të nënshtrohet ndikimeve politike, klanore dhe familjare. Vërejtjet më të mëdha të viteve të fundit si nga Avokati i Popullit, por në përgjithësi nga opinioni publik, kanë qenë se Sektori për Kon-

troll të Brendshëm në MPB nuk e kryen punën e tij si duhet. Toleranca apo heshtja ndaj reagimeve të qytetarëve për punën e policisë shpesh herë kanë rezultuar me pasoja të rënda. Degradimi në vend publik, rrahjet dhe zënkat e ndryshme janë vetëm disa nga shkeljet, të cilat pjesëtarë të policisë i kanë bërë në të kaluarën, por se procedimi i këtyre rasteve brenda policisë ka ndodhur pasi janë shkaktuar dëmet. Për gazetën KOHA nga MPB bëjnë të ditur se nga fillimi i vitit e deri kah mesi i shtatorit Sektori i për Kontroll të Brendshëm ka iniciuar 27 procedura për vërtetim të përgjegjësisë disiplinore.

"Lëndët disiplinore janë hapur për të konstatuar veprat penale apo ato për kundërvajtje, me elemente të dhunës apo njëkohësisht janë obliguar eprorët përkatës që personave në fjalë t'iu konfiskohen armët dhe municioni", thonë nga MPB.

Ndryshe, edhe pse gazeta

KOHA duke u mbështetur në zhvillimet e fundit kërkoi sqarim nga drejtuesit e policisë së shtetit se vallë në të ardhmen do të ashpërsohen kriteret për praninë të pjesëtarëve të ri, ata nuk u përgjigjen. Megjithatë, prononcimi i tyre kryesisht lidhet me kompetencat ligjore që i gëzojnë pjesëtarët e policisë për mbajtjen e armës, gjegjësisht konfiskimin e tyre. Normat e ligjit për polici thonë se arma me municion do të merret një nëpunësi, atëherë kur ndaj tij do të filloj procedura për kryerjen e veprës penale apo asaj për kundërvajtje. Një veprim i tillë i drejtuesve të policisë mund të ndodhë edhe atëherë kur ata pranojnë njoftime nga Qendra përkatëse për punë sociale, se një nëpunës policor ka marrë pjesë në dhunë familjare. Ndryshe, policia e shtetit nuk disponon me të dhëna se sa është numri i armëve ilegale që gjenden në duart e qytetarëve.

Maqedonia bashkëpunon në përpjekjet antiterroriste

Shkup, 20 shtator - Maqedonia bashkëpunon me Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) në përpjekjet antiterroriste dhe është anëtare e Koalicionit global për mposhtje të Shtetit Islamik, qëndron sot në raportin e publikuar të Stejt Departamentit për terrorizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm. Autoritetet e Maqedonisë vlerësojnë se pjesëtarë dhe ithtarë të ISIS-it janë të pranishëm në shtet. MPB dhe Agjencitë e zbulimit vlerësojnë se më së paku 150 shtetas të Maqedonisë kanë udhëtuar që të inkuadrohen në grupet terroriste në Siri dhe në Irak. Prej tyre, 30 janë vrarë, 40 ende janë të pranishëm atje, derisa 80 janë kthyer në Maqedoni, qëndron në raportin. Mes tjerash, theksohet se Maqedonia ndërmerr masa për forcimin e legjislativës dhe forcimit të kapaciteteve për luftë kundër terrorizmit dhe financimit të saj si dhe forcimit të sigurisë kibernetike dhe bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtar. Policia kufitare e Maqedonisë dhe dogana janë anëtarë të nismës për bashkëpunim kufitar, qëllimi i së cilës është të formohet grup ndërkufitar i punës për siguri kufitare nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi për luftë kundër korrupsionit, kontrabandës, krimin transnacional dhe terrorizmit.

Arrestohet një tetovar me armë dhe drogë

Tetovë, 20 shtator - Pistoletë me katër plumba, thikë, peshore digjitale, heroinë dhe hashash ka gjetur policia tek personi F.S (29) nga Tetova gjatë bastisjes në shtëpinë e tij, ka informuar zëdhënësi i SPB-Tetovë, Marjan Josifovski. Sipas të dhënave të tij, tetovari i cili ka drejtuar me motoçikletë është vërejt nga policët dje në ora 18 e 30 minuta në bulevardin "Vidoja Smilovski-Bato" që kalon afër shkollës fillore "Kirili dhe Metodi". "Kur policët janë afruar deri te ai, ka filluar të ikë dhe ka hedhur pistoletën 'Brauning', me kalibër 7.65 milimetër me kornizë prej katër plumbave që i ka poseduar pa leje. Shpejt ai është kapur dhe privuar nga liria dhe gjatë kontrollit të motoçikletës nën sedilje është gjetur thikë. Pak më vonë është kryer bastisje në shtëpinë e tij dhe hapësira ndihmëse ku janë gjetur

dy peshore digjitale, heroinë dhe hashash. Gjithçka që është gjetur është marrë dhe do të bëhet ekspertizë me çka kundër F.S, që është mbajtur në stacion policor në Tetovë do të ketë masë adekuate", ka thënë Josifovski. Sipas të dhënave policore vetëm në dy javët e fundit në rajonin e Tetovës dhe Gostivarit janë arrestuar rreth 70 persona të cilët dyshohen se kanë marrë pjesë në shitjen apo përdorimin e marijuanës, heroniës dhe kokainës. Pjesa më e madhe e personave janë nga Tetova, Gostivari dhe më shumë fshatra në moshë prej 15 deri 46 vjeç. Nga policia, madje paralajmërojnë se pas pastrimit të rastit për personat e identifikuar të cilët kanë marrë pjesë në shitjen apo kanë përdorë mjete narkotike do të pasojnë parashtrësia. (U.H)

KRONIKË

Vetura godet rëndë

6-vjeçarin

Një djalë gjashtëvjeçar është lënduar rëndë pasi dje u godit nga një veturë në fshatin Sfilare e Poshtme. MPB-ja njoftoi se dje në orën 15:20 në fshatin Kondovë, të Shkupit, një veturë e tipit "Pasat" me targa të Shkupit, e drejtuar nga I.M (54) nga fshati Sfilare e Poshtme, ka goditur djalin gjashtëvjeçar nga Gllumova. Nga goditja fëmija ka marrë lëndime të rënda trupore dhe është dërguar në Klinikën për fëmijë në kuadër të kompleksit të klinikave "Nënë Tereza". Është kryer ekspertizë në vendin e ngjarjes.

Mbi 70 të arrestuar për lëndë narkotike

Sektori për Punë të Brendshme Tetovë vazhdon me aktivitetet intensive të koordinuara, për zbulimin dhe sanksionimin ligjor të personave që posedojnë, shesin dhe konsumojnë drogë. Vetëm gjatë dy javëve të fundit, në zonën e më të gjerë të Tetovës dhe të Gostivarit, janë arrestuar mbi 70 persona, të involvuar në shitje ose përdorim në të shumtën e rasteve marihuanë, por edhe heroinë dhe kokainë. Në të shumtën e rasteve bëhet fjalë për persona nga Tetova dhe Gostivari të moshës prej 15 deri 46 vjeç, si dhe nga më shumë fshatra të rajonit, të cilët kanë poseduar ose kanë përdorur lëndë narkotike. Pas zbardhjes së të gjitha detajeve në veçanti, kundër personave të zbuluar do të pasojnë edhe padi adekuate.

Aksident në Neproshten, dy të lënduar

Në rrugën regjionale Tetovë-Jazhincë, në fshatin Neproshten, ka ndodhur një aksident trafiku në të cilin kanë marrë pjesë dy vetura me targa të Tetovës, gjegjësisht vetura e tipit "Fiat Punto" e drejtuar nga 31 vjeçari J.Q. nga fshati Leshkë dhe vetura e tipit "Opel Corsa", të cilën e ka drejtuar personi A.A. 22 vjeçar nga Tetova. Vozitësi i lënduar dhe bashkudhëtari nga vetura "Opel Corsa" S.A. 30 vjeçari nga fshati Merovë me anë të një veture tjetër janë dërguar në Spitalin Klinik të Tetovës, ku pas dhënies së ndihmës mjekësore, personi A.A. është mbajtur për mjekim të mëtutjeshëm ndërsa bashkudhëtari S.A. është lëshuar në shtëpi. Janë kryer hetimet në vendin e ngjarjes, dhe punohet në zbardhjen e shkakut, rrethanave dhe detajeve tjera lidhur me aksidentin.

Pesë të lënduar në një aksident në Gradsko

Pesë persona janë lënduar gjatë një fatkeqësie komunikacioni që ndodhi dje rreth orës 13:30 në rr. "Marshall Tito" në Gradsko mes një motoçiklete të llojit "Jamaha" me targa të Shkupit, drejtuar nga P.S.(20) nga f.Drenovë i Kavadarit dhe një automobili të llojit "Mazda-3" me targa të Kavadarit, drejtuar nga O.A.(40). Siç sqaroi Veroljub Dodevski, zëdhënësi i SPB Veles, pas fatkeqësisë, për kontroll mjekësor në Entin privat shëndetësor në Gradsko janë paraqitur të gjithë pjesëmarrësit. "Janë konstatuar lëndime tek vozitësi i motoçikletës dhe bashkudhëtari i tij S.P.(30), përderisa vozitësi i automobilin dhe bashkudhëtarët e tij G.S.(69) dhe A.S.(35), pas ndihmës së ofruar mjekësore janë udhëzuar për mjekim spitalor", tha Dodevski. Ekspertizë në vendin e ngjarjes ka kryer ekipi nga SPB Veles. (U.H)

POTENCIALI I MAQEDONISË DREJT EVROPËS

TREGJET JANË TË HAPURA, PO NA MUNGOJNË STANDARDET EVROPIANE

"Tregu austriak dhe tregu në Evropë nuk kanë pengesa në importimin e produkteve maqedonase, veçmas në industrinë elektronike dhe të metalit, por në mundësitë e bashkëpunimit vërehet edhe mungesë e standardeve adekuate që kompanitë maqedonase duhet t'i përmbushin që të mund të jenë serioz dhe konkurrues në tregjet e Evropës", ka thënë Daniella Mihajlovska nga Oda Ekonomike e Maqedonisë

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 20 shtator - Tregjet në Evropë nuk kanë pengesa për të importuar produktet maqedonase, por ajo çka u mungon kompanive të Maqedonisë është të përmbushin standardet e duhura që janë të pranueshme në Bashkimin Evropian. Në këtë njoftojnë nga Oda Ekonomike e Maqedonisë dhe kompanitë e huaja të cilët shohin potencial për bashkëpunim me firmat e Maqedonisë.

"Shohim potencial të madh për bashkëpunim me tregun maqedonas, këtë e tregojnë edhe numrat, apo në gjysmën e parë të këtij viti këmbimi tregtar është rritur. Veçmas vlerësohet cilësia e bashkëpunimit. Pra, kërkohen



partnerë të cilët posedojnë certifikatë të njohur nga BE", ka thënë Marline Burgstaler, zëvendës udhëheqës i Sektorit tregtar të Ambasadës austriake në Republikën e Serbisë, përgjegjëse edhe për Maqedoni e cila sot është në Shkup bashkë me përfaqësues të kompanive austriake nga industria elektronike dhe metaleve. Edhe nga Oda Ekonomike e Maqedonisë pohojnë se përmbushja e standardeve evropiane është ajo që u mungon kompanive të Maqedonisë.

"Tregu austriak dhe tregu në Evropë nuk kanë pengesa në importimin e produkteve maqedonase, veçmas në industrinë elektronike dhe të metalit, por në mundësitë e bashkëpunimit vërehet edhe mungesë e standardeve adekuate që kompanitë maqedonase duhet t'i përmbushin që të mund të jenë serioz dhe konkurrues në tregjet e Evropës", ka thënë Daniella Mihajlovska nga Oda Ekono-

mike e Maqedonisë para takimeve të djeshëm të punës mes kompanive të Austrisë dhe Maqedonisë. "Kërkojmë partnerë të rinj me të cilët do të bashkëpunojmë. Ne jemi këtu dhe ofrojmë mbështetje për partnerët tanë, pra kemi ekip të ekspertëve të kualifikuar që vijnë tek furnizuesit tanë dhe ndihmojnë në ngritjen e nivelit të prodhimit në nivel që të mund të përmbushin kushtet për certifikatat e tyre", ka thënë Markus Gruber nga "Putinger lan teknik". Ajo që për investitorët e huaj paraqet problem që të investojnë në vend, sipas zëvendës udhëheqëses Burgstaler, janë sundimi i të drejtës dhe korrupsionit, por siç thotë, "Maqedonia ka bërë përparim të madh në muajt e fundit".

"Nëse e lexoni raportin për përparimin nga ana e BE-së do të shihni se aty është e shkruar gjithçka. Aty flitet për mungesë të sundimit të së drejtës, proble-

me me korrupsionin...Por sipas mendimit tim duke e lexuar tërë raportin mendoj se aty ka një ton optimist. Është vërtetuar se Maqedonia ka bërë progres të madh në disa muajt e fundit dhe shpresojmë se ajo kështu do të vazhdojë", ka thënë Burgstaler.

Këmbimi tregtar mes Maqedonisë dhe Austrisë në vitet e fundit shënon rritje në vazhdimësi veçmas në rritjen e eksportit të produkteve maqedonase në tregun austriak dhe dinamikë më të vogël të rritjes së importit nga Austria. Në shtatë muajt e fundit të këtij viti këmbimi tregtar në total kap vlerën 183.2 milionë dollarë amerikan që paraqet rritje prej 77.11 për qind krahasuar me periudhën e njëjtë vitin e kaluar. Austria këtë vit është partneri i 12-të tregtar në Maqedoni për dallim nga viti 2016 kur ka qenë në vendin e 19-të. Në 2016, sipas të dhënave të Bankës Popullore të Maqedonisë Austria ka pasur më shumë investime në Maqedoni.



10 milionë euro kredi për Kriva Pallankë-Deve Bair

Shkup, 20 shtator - Me 10 milionë euro kredi nga Banka Evropiane për Ripërtëritje dhe Zhvillim tërësisht do të rikonstruohet dhe modernizohet rruga nga Kriva Palanka deri te vendkalimi kufitar Deve Bair në gjatësi prej 13 kilometrave, i cili do të zgjerohet me kors të tretë. Me nënshkrimin e sotëm të marrëveshjeve për hua dhe garancë, në Ministrinë e Financave u krijuan kushte për fillim të punëve ndërtimore, që janë vazhdim i rrugëve të filluara ekspres nga Rankovci deri në Kriva Pallankë, të cilat duhet të jenë gati për dy deri tre vite. "Borxhi është me afat të pagesës deri 15 vjet dhe grejs periudhë prej dy viteve, me shkallë varabile të interesit, e cila përbëhet nga eurolibor gjashtëmujor, të rritur për marginë prej një për qind. Shkalla e interesit tani është rreth 1 për qind dhe tani ka kushte jashtëzakonisht të volitshme në treg", informoi pas nënshkrimit të marrëveshjeve, ministri i Financave, Dragan Tevdovski. Ai potencoi se projekti do ta përmirësojë lidhjen e Maqedonisë dhe Bullgarisë, me të cilën vitin e fundit seriozisht e rrisim këmbimin tregtar dhe se si pjesë për lidhje të Detit të Zi me atë Adriaktik është me rëndësi të madhe jo vetëm për ekonominë e Maqedonisë, por edhe për rajonin. Sipas kushteve për kredinë, Ndërmarrja publike për rrugë shtetërore (NPRRS) do të duhet t'i paguajë BERZH-it provizion të njëfishtë me vlerë prej një për qind nga vlera e borxhit, si dhe provizion për pjesë që nuk tërhiqet të borxhit me vlerë prej 0,5 për qind në nivel vjetor.

Kjo masë për mbështetjen e fermerëve të rinj, e realizuar përmes Programit për Zhvillim Rural për vitin 2018, ka ndryshime në kriteret, kurse qëllimi është që t'iu jepen shans fermerëve të rinj që janë të papunë

Koha Remzije BILALLI

Shkup, 20 shtator - Të gjithë fermerët e rinj, deri në moshën dyzetvjeçare, që janë të regjistruar në regjistrin e fermave bujqësore, në përputhje me Ligjin për zhvillimin rural, nga sot (e premte) deri më 19 tetor mund të aplikojnë për fonde për fermer të ri nga Programi për Zhvillim Rural. Investimi maksimal

FONDE PËR ZHVILLIM RURAL

PËR BUJQIT E RINJ, 10 EURO TË PAKTHYESHME

është 600.000 denarë, ose 10 mijë euro, ndërkaq fondet mund të përdoren për të filluar veprimtari bujqësore, që nënkupton investime në pajisje për përpunimin e produkteve bujqësore dhe produkteve shtazore, si dhe për hapjen e agrobizneseve. Drejtori i Agjencisë për Mbështetjen Financiare të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Nikolçe Babovski, deklaroi se ardhmja e vendit është rinia prandaj duhet të përkahehen maksimalisht.

"Fondet ndahen gjatë periudhës së realizimit të planit të biznesit dhe paguhet çdo vit në maksimum prej tre këstesh. Mbështetja kushtë-

zohet nga përmbushja e detyrueshme e aktiviteteve të parashikuara nga plani i biznesit dhe një nga kushtet për marrjen e këtyre fondeve është që aplikanti të mos jetë më i moshuar se 40 vjet. Të gjithë të interesuarit kërkesat mund ti dërgojnë pas regjistrimit në formë elektronike në: e-baranje.ipardpa.gov.mk", shpjegon Babovski.

Kjo masë për mbështetjen e fermerëve të rinj, e realizuar përmes Programit për Zhvillim Rural për vitin 2018, ka ndryshime në kriteret, kurse qëllimi është që t'iu jepen shans fermerëve të rinj që janë të

papunë. Më shumë pikë do t'u jepen të rinjve që janë të papunë për më shumë se dy vite, si dhe anëtarëve të rinj të kooperativave bujqësore. Një aplikues mund të paraqesë vetëm një kërkesë për një masë ose më së shumti dy kërkesa për masa të ndryshme.

Kërkuar i mbështetjes financiare është e nevojshme të kërkojë një kërkesë elektronike për mbështetje financiare me të dhënat e vendndodhjes në investime dhe në mënyrë elektronike t'i bashkëngjese dokumentet (Oferta /pro forma për planin e investimeve dhe të biznesit të propozuar të përgatitur në

përputhje me formularin e parashikuar "Biznes Plan për masën 112").

Kërkesat të cilat nuk paraqiten në mënyrë elektronike nuk do të merren parasysh. Ndërsa kërkesat e plotësuara në mënyrë elektronike është e nevojshme të shtypen dhe së bashku me dokumentet tjera të dorëzohen në Agjencinë për Mbështetje Financiare të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Vitin e kaluar, Agjencia për Mbështetjen Financiare të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural realizoi kontrata me 424 fermerë të rinj në vlerë prej mbi 4 milionë euro.

Pas Maqedonisë renditet Shqipëria me 8.8 vdekje për 1000 fëmijë, e pasuar nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina me 5.7 vdekje për 1 mijë fëmijë, derisa Mali i Zi ka nivelin më të ulët të vdekshmërisë në rajon, me 3.5 në 1000 fëmijë

Shkup, 20 shtator - Maqedonia me 13.7 vdekje për 1000 fëmijë është shteti që kryeson me këtë problematik në Ballkan. Të dhënat më të reja të Bankës Botërore tregojnë se edhe pse ka pasur përparim të dukshëm në reduktimin e vdekshmërisë tek fëmijët dhe adoleshentët, masat serioze vazhdojnë të mungojnë. Pas Maqedonisë renditet Shqipëria me 8.8 vdekje për 1000 fëmijë, e pasuar nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina me 5.7 vdekje për 1 mijë fëmijë, derisa Mali i Zi ka nivelin më të ulët të vdekshmërisë në rajon, me 3.5 në 1000 fëmijë.

Sipas raportit të BB-së, mes viteve 1990 dhe 2017, niveli i vdekshmërisë nën pesë vjeç u ul me 58 për qind nga 93 vdekje për 1000 lindje të gjalla deri në 39 vdekje për 1000 lindje të gjalla. Gjatë 17 viteve të fundit, reduktimi i nivelit të vdekshmërisë nën pesë vjeç u përshpejtua në një reduktim vjetor prej 4% në

RAPORT SHQETËSUES I BANKËS BOTËRORE

MAQEDONIA E PARA ME VDEKJEN E FËMIJËVE!



krahasim me një reduktim vjetor prej 1.9% mes viteve 1990 dhe 2000.

"Megjithatë, ndërsa një reduktim i konsiderueshëm nga 14.3 milionë në vitin 1990, rreth 6.3 milionë fëmijë nën moshën 15 vjeç humbën jetën në vitin 2017, kryesisht nga shkaqe të parandalueshme. Shumica dërrmuese e këtyre vdekjeve - 5.4 milionë ndodhën në pesë vitet e para të jetës. Pothuajse gjysma e vdekjeve të fëmijëve nën moshën 5 vjeçare u llogaritën nga vdekjet neonatale (2.5 milion). Muaji i parë i jetës është periudha më e prekshme për fëmijët", thuhet në raport. Progresi drejt reduktimit të vdek-

shmërisë neonatale ndërmjet viteve 2000 dhe 2017 ka qenë 1.5 herë më i ngadalshëm se sa për fëmijët më të mëdhenj (nën 5 vdekje pas muajit të parë të jetës) për të njëjtën periudhë, thotë më tej raportit. Për të ulur më tej vdekjet e fëmijëve, sugjeron raportit, duhet përmirësuar qasja universale në shërbimet shëndetësore cilësore dhe të përballueshme, veçanërisht gjatë kohës së lindjes dhe gjatë viteve të hershme. Raporti thotë në 2017, 118 vende tashmë kishin një normë të vdekshmërisë nën pesë vjeç nën synimin e SDG (jo më shumë se 25 vdekje për 1,000 lindje të gjalla).

Ndër 77 vendet e mbetura, përparimi do të duhet të përshpejtohet në rreth 50 vende për të arritur objektivin e SDG deri në vitin 2030.

"Shanset për mbijetesë varen shumë se ku lindin fëmijët. Nga shtetet e marra në studim, Somalia ka shkallën më të lartë të vdekshmërisë nën moshën pesë vjeçare, në 127 për 1,000 (1 në 8 fëmijë vdes), ndërsa Islanda dhe Sllovenia kanë raportin më të ulët, me 2.1 për 1,000 (1 në 476 fëmijë vdes). Fëmijët në Somali kanë 60 herë më shumë gjasa të vdesin në pesë vitet e para të jetës sesa ato në Islandë dhe Slloveni", thuhet në raport.



Pančevski në Prokurori për "AKMIS"-in

Shkup, 20 shtator - Nën dyshimin e trupimit të lëndëve gjyqësore, ish kryetari i Gjykatës Penale të Shkupit, Vlladimir Pančevski, të enjten është paraqitur në Prokurorinë Publike. Keqpërdorimi i "AKMIS" sistemit është vepra penale që dyshohet se Pančevski gjatë mandatit të tij katërvjeçar, respektivisht keqpërdorimi i pozitës zyrtare dhe veprimet e pandërgjegjshëm. Për të dy veprat penale Kodi Penal i Maqedonisë parasheh dënime me burg. Ndryshe, Pančevski për më tepër se një vit e më tepër është nën hetimet e Prokurorisë Speciale Publike, nën dyshimin se trupimit të lëndëve me karakter të parburgimit. Dyshimet të cilat PSP i heton lidhet me faktin se ai në të gjitha fazat e procedurës paraprake, gjatë asaj për ankimim të vendimeve e deri te ndarja e lëndëve gjykatësve, ka bërë shkelje ligjore. Manipulimet shtesë, të cilët dyshohet se ai i ka kryer lidhen me Sistemin e shpesh të gjykatësve. Me këto veprime, Pančevski dyshohet se "gjykatësit e rebeluar" i ka transferuar në sektorin për shqyrtimin e lëndëve për kundërvajtje. Tutje e pjesë e këtyre hetimeve si nga Prokuroria e rregulltë ashtu edhe nga PSP është edhe kreu i Gjykatës së Lartë, Jovo Vangelovski dhe ish ushtruesja e detyrës, gjykatësja Snezhana Bajlozova, e cila në cilësinë e dëshmitares të premtën është intervistuar në Prokurorinë Publike të Shkupit. Gjykatësi Pančevski, i cili për momentin është i deleguar për shqyrtimin e lëndëve për kundërvajtje, pas daljes nga prokuroria nuk ka dashur të jep deklaratë për media. Javën e ardhshme, në Prokurorinë Shkupit, pritet të paraqitet Jovo Vangelovski, i dyshuar për keqpërdorim të detyrës zyrtare.

Vizbeg më në fund me ujësjellës dhe kanalizim

Shkup, 20 shtator - Në zonën industriale Vizbeg në nëntor të këtij viti do të fillojë ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit dhe të kanalizimit, për çka do të investohen tetë milionë euro, paralajmëruan gjatë vizitës së sotme në këtë zonë, ministri i Transportit dhe Lidhjeve, Goran Sugareski dhe kryetari i Komunës së Butelit, Velimir Smilevski. Ndërmarrja Publike "Ujësjellësi dhe kanalizimi" në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve sot e dorëzoi projektin për ndërtimin e ujësjellësit me gjatësi prej shtatë kilometrash, ndërsa Ministria dikasteriale, siç tha Sugareski, në afat sa më të shpejtë të mundshëm do të përgatisë dokumentacion në terren



dhe do të shpallë thirrje për ndërtim. Financat për realizimin e projektit janë planifikuar në buxhetet e Ministrisë në vitet në vijim.

"Pritjet janë që projekti të jetë gati në vitin 2020, por planifikojmë

me përpjekje të madhe nëse mund të përfundojë edhe deri në fund të vitit të ardhshëm", tha Sugareski. Në bashkëpunim me Komunën e Butelit dhe Qeverinë, do të rregullohet infrastruktura në zonën e Vizbegut me çka, sipas ministrit,

do të realizohet premtimi para biznesmenëve të cilët punojnë për sigurimin e kushteve më të mira për punë.

Në zonën industriale Vizbeg, punojnë rreth 200 kompani, ndërsa sipas kryetarit të Komunës së Butelit, Velimir Smilevski, ka dobi për ndërtimin e kapaciteteve dhe nga ekonomistë të tjerë, për çka punohet në planin e detajuar. Në zonë, përveç fillimit të ardhshëm të punës për ndërtimin e ujësjellësit i cili do të ndërtohet me 1,6 milionë euro dhe në rrjetin e kanalizimit për çka do të shpenzohen shtatë milionë euro, do të përmirësohet edhe infrastruktura rrugore. (Z.V)

Katër projekte nga thirrja publike "Vakt për të gjithë"

krijimin e një zgjidhjeje inovative sistematike të qëndrueshme për sigurimin e ushqimit për kategoritë e rrezikuara të qytetarëve. Prej tyre, sot ose në ditët në vijim, do të duhet të jetë e zgjidhur më e mira zgjidhje dhe të konvertohet në një sistem përmes të cilit ushqimi do të sigurohet për këtë kategori të qytetarëve, domethënë do të mundësojë tepricat e ushqimit nga kompanitë, tregjet e mëdha, objekte hoteliere etj.

"Rreth 450 mijë njerëz kanë nevojë reale për të mbështetur shtetin në sigurimin e kushteve elementare për jetesë, ndër të tjerat të ushqimit. Qëllimi i sfidës 'Vakt për të gjithë' është nëpërmjet bashkëpunimit të organizatave joqeveritare, kompanitë dhe institucionet publike për të ardhur në një model të ri që do të përfshijë të gjithë, dhe që për këta qytetarë do të sjellë atë që ata kanë nevojë - ushqim", tha Jovan Despotovski,

drejtor i Fondit për Inovacion dhe Zhvillim Teknologjik. Në Maqedoni, theksoi ai, ekzistojnë një numër i madh të iniciatorëve, dhe qëllimi "Vakt për të gjithë" nuk është për të futur një zgjidhje paralele tek ata, por për të krijuar mbështetje sistematike, pjesë e sistemit shtetëror. Ministrja për Punë dhe Politik Sociale, Mila Carovska, theksoi që nevoja për të krijuar një sistem është rezultat i perceptimeve se zgjidhjet e sheshta nuk japin

rezultate. Për shembull, kuzhinat kombëtare, tha ajo, janë të shtrenjta për të mbajtur dhe për të shërbyer një numër të vogël qytetarësh. Janë paraqitur projekte të Entit për analiza të materialeve dhe zhvillim të teknologjive të reja nga Shkupi. "Ushqim për të gjithë", "Banka për ushqim, Maqedoni", "Hajde Maqedoni", DAMA-EL Shokata për fëmijët me nevoja të posaçme dhe Qendra ditore Sh Cirilo CHEF "Shkathtësi për jetë". (Q.A)



Shkup, 20 shtator - Gjatë ditës së sotme në Fondin për Inovacion dhe Zhvillim Teknologjik u prezantua projekti "Vakt për të gjithë", ku janë caktuar katër projekte nga thirrja publike për dhënie e fondeve për

MASKAT OPEROJNË NË TETOVË

PËR NËNTË MUAJ, 10 PLAÇKITJE ME MASKA

Policia ende nuk ka dalur me qëndrim se a bëhet fjalë për grup të organizuar apo bëhet fjalë për raste të ndara, megjithëse vjedhjet e kësaj natyre janë shfaqur kohë pas kohe, kurse gjysma prej tyre janë zbardhur



Koha Urim HASIPI

Tetovë, 20 shtator - Tashmë një kohë të gjatë në Tetovë dhe rrethinë regjistrohen vjedhje të rënda, gjegjësisht plaçkitjet me armë nga persona të maskuar. Zakonisht, gjatë kësaj kohe, cak i këtyre vjedhjeve kanë qenë marketet dhe këmbimoret, apo Agjencitë për transfere të parave. Disa prej këtyre vjedhjeve janë zbardhur, disa ende janë në zbardhje e sipër, por vjedhjet me maska janë ende prezente në këto hapësira. Kryesisht në këto plaçkitje me armë dhe me maska, kanë marrë pjesë më

shumë persona, apo grup i cili në të shumtën e rasteve vetëm kanë kërcënuar punonjësit dhe me sendet e vjedhura janë larguar nga vendi i ngjarjes, duke mos u shkakuar lëndime personave që kanë qenë prezent në momentin e vjedhjeve.

Nga Policia e Tetovës, njoftuan se brenda nëntë muajve janë regjistruar dhjetë plaçkitje me maska. "Në periudhën prej një janarit e deri më 19 shtator të këtij viti, në rajonin më të gjerë të Tetovës, kanë ndodhur 10 plaçkitje dhe 2 tentime për plaçkitje, prej të cilave në 7 prej tyre janë përdorur maska fantome nga ana e plaçkitësve, ndërsa në 9

raste janë përdorur armë edhe atë në 8 raste armë zjarri dhe në një raste armë e ftohtë. Sektori për Punë të Brendshme Tetovë, deri më tani ka zbardhur 6 të raste të plaçkitjeve, ndërsa rastet tjera janë në procedurë e sipër", deklaroi zëdhënësi i Sektorit për Punë të Brendshme në Tetovë, Fatmir Rexhepi.

Por ajo që është e veçantë në vjedhjen e fundit në Tetovë, ku në një Agjenci për transfere parash, për herë të parë vjedhja kryhet nga një shtetas i huaj, që në këtë rast rezultoi të jetë italian, i asistuar nga dy shtetas të Tetovës dhe një vajzë nga Italia. Sipas informacioneve jozyrtare, shtetasi italian

madje është edhe kryerës i veprës plaçkitjes dhe ka hyrë brenda në agjenci, ndërsa tre tjerët kanë qenë të angazhuar si logjistikë. Sipas njohësve të këtyre rrethanave, zakonisht në këto raste, kryerësi nuk flet gjatë aktit të plaçkitjes për shkak që të mos njihet se çfarë përkatësi ka që më pas policia ta ketë më vështirë kapjen e të njëjtit.

Kështu edhe kishte qenë gjatë kësaj vjedhje, ku shtetasi italian nuk kishte folur aspak me punonjësin, por vetëm ka bërë me shenjë që ai të hap arkën prej metali ku i mbajnë paratë. Policia ende nuk ka dalur me qëndrim se a bëhet fjalë për grup të organi-

zuar i cili funksionon në këto hapësira apo bëhet fjalë për rasteve të ndara, megjithëse vjedhjet e kësaj natyre janë shfaqur kohë pas kohe, kurse gjysma prej tyre janë zbardhur, ndërsa ajo që bie në sy është se vjedhja e parave në kombin e transferit të parave nga marketi "Kipper" gjatë muajit qershor, në Reçicë të vogël, dhe plaçkitja në këmbimore që ndodhi këtyre ditëve në sipas informacioneve policore njëri prej personave është i involvuar në të dy këta raste. Kësisoj, vjedhjet dhe plaçkitjet e shumta në rajonin e Tetovës që kryhen nga personat e maskuar shqetësojnë pa masë qytetarët. Ata janë shprehur se policia duhet që sa më shumë të punojë në këtë drejtim me qëllim që të evitohet plaçkitjet e këtilla. Qytetarët theksojnë se në këtë mënyrë ndjehen të pasigurt, sepse shumë lehtë mund të jenë cak të hajnave. Nga policia është kërkuar që qytetarët në kohë sa më të shpejtë të denoncojnë ngjarjet dhe dukuritë devijuese në atë rajon me qëllim që në mënyrë efikase të merren masa. Kohëve të fundit në Tetovë dhe më gjerë janë regjistruar vjedhje të rënda jo vetëm në qytet por edhe në vendbanimet rurale. Madje pjesa dërmuese e vjedhjeve kryhen nga persona të maskuar dhe të armatosur gjatë orëve të natës.

Matës të shpejtësisë para pesë shkollave në Shkup

Shkup, 20 shtator - Matës digjital të shpejtësisë do të vendosen në afërsi të pesë shkollave të mesme në Shkup. Qëllimi i kësaj nisme është rritja e vetëdijes së shoferëve dhe sigurisë me e madhe në komunikacion. Qyteti i Shkupit këta matës shpejtësie i mori si donacion nga kompania e sigurimit "Sava Sigurime" SHA Shkup. Matësit do të vendosen në gjimnazin "Josip Broz Tito", në shkollën e mjekësisë "Pançe Karagjovov", SHMN "Zdravko Cvetkovski", shkollën e mesme të kimisë "Marija Kiri Skllodovska" dhe QSHAK "Boro Petrushevski".

MBËSHTETJE EVROPIANE PËR BASHKËPUNIMIN E OQJ-VE ME PUSHTETIN LOKAL

Edhe 10 milionë euro për demokracinë lokale

Shkup, 20 shtator - Përforsim i kapaciteteve të administratës lokale dhe të sektorit civil për bashkëpunim transparent është prioriteti i projektit për bashkëpunimin e autoriteteve lokale dhe organizatave joqeveritare të Ballkanit Perëndimor, për të cilin Bashkimi Evropian i ndau 10 milionë euro, theksoi ministri i Vetëqeverisjes Lokale, Suhejl Fazliu, në konferencën e djeshme rajonale për promovimin e demokracisë lokale në Ballkanin Perëndimor. Ai theksoi se bëhet fjalë për një projekt shumë të suksesshëm i cili për herë të parë ka filluar të zbatohet në Bosnjë e Hercegovinë, ndërsa më pas, siç theksoi, gjëja më e suksesshme e këtij projekti është që arriti të shumëfishohet. "Në vitin 2017 Bashkimi Evropian i ndau 10 milionë euro në mënyrë që projekti të jetë rajonal në të gjitha gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor", theksoi Fazliu.

Ai theksoi se qëllimi kryesor i projektit është financimi më i suksesshëm i organizatave joqeveritare lokale nga ana e autoriteteve lokale. "Rreth 40.000 qytetarë do të fitojnë mjete në 50 qytete dhe ko-



PEŠË KOMUNAT QË PËRFITOJNË GRANTE NGA 120 MIJË EURO

Pesë komuna në Maqedoni - Kumanova, Kavadari, Gostivari, Strumica dhe Resnja do të marrin grante prej 120.000 euro për përmirësimin e shërbimeve sociale, në veçanti për grupet e rrezikuara dhe të marginalizuara, në bashkëpunim me shoqërinë civile. Fondet sigurohen nga Bashkimi Evropian, në kuadër të një projekti rajonal që implementohet në Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi, Shqipëri, Kosovë dhe Republikën e Maqedonisë.


muna në të gjitha gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor", tha Fazliu. Ministri Fazliu potencoi se projekti zbatohet nga viti 2017 deri në vitin 2020, ndërsa për atë do të shpallet konkurs publik sipas kriterëve të cilat do t'i vendos UNDP-ja në bazë të asaj cilat organizata joqeveritare do t'i fitojnë grantet. "Në Ballkanin Perëndimor ka autoritete lokale të

qilat përballen me probleme lidhur me mungesën e burimeve njerëzore, mungesën e burimeve financiare, por edhe pjesëmarrjen e pamjaftueshme nga sektori civil", theksoi Nikolla Bertolini, përfaqësues i Delegacionit të BE-së në Maqedoni. Ai tha se nga përvoja të cilën e kanë me UNDP-në në BeH kanë parë se në fakt, projekti mund të bëjë dallim

dhe se mund të fillojë një proces i pilotimit të bashkëpunimit më të mirë midis autoriteteve lokale dhe sektorit civil.

"Thelbi i këtij projekti është shpërndarja më e mirë dhe më transparente e mjeteve nga autoritetet lokale të organizatave nga sektori civil, por gjithashtu, rëndësi të madhe ka edhe rritja e kapaciteteve të të punësuarve në vetëqeverisjen lokale", tha Bertolini. Ai potencoi se demokracia lokale në fakt, fillon nga sigurimi i mjeteve të cilët do të mund të sigurojnë shërbime për vetë qytetarët, ndërsa organizatat civile, shtoi, gjithashtu duhet të dinë se si të marrin pjesë dhe si ta shfrytëzojnë këtë proces. "Me të vërtetë jemi krenarë që jemi partnerë dhe që e zbatuam këtë program në Maqedoni. Elementi kryesor i këtij programi është të përforsohet bashkëpunimi midis autoriteteve lokale dhe sektorit civil, ndërsa ne konsiderojmë se ai është element kyç për arritjen e një demokracie participative", theksoi Narine Sahakijan, zëvendësi i përfaqësueses së përhershme të UNDP-së në Maqedoni. (Q.A)

(Jo gjithmonë) urdhri e ka bishtin prapa!



Nga
Fadil LUSHI

Miku im i dashur dhe i paanshëm! Unë besoj shumë se do më ndjesh nëse në këtë shkrim për gazetë (ndoshta me a pa hir, me a pa sebeb) do ta teproj me fjalorin fyes, me gjuhën denigruese, me disa sllavizma e otomanizma si dhe me ca mesele nga përditshmëria jonë e bezdisshme dhe e njëtrajtshme. Mbaj mend se, kur isha një çun çapkën, me shumë vështirësi i zbatoja urdhrat a porositë me gojë të prindërve si dhe të mësueses sime. Edhe ata pak urdhra që i vija në jetë më dukeshin si të ishin luftarakë, hajt, të mos themi edhe banale. Sot e kësaj dite më kujtohet meseleja kur pushtetarët nga komunisti, ma "morën masën e samarxiut" si dhe një takim me një punonjës të hetuesisë. Ai urdhëroi dhe kërkoi bashkëpunimin tim me organet e ndjekjes. Para se ta kundërshtoja kërkesën dhe para se të më fuste në kurthet e tij mjerane, ai më tha: "Ki parasysh, jo gjithmonë urdhri e ka bishtin prapa!..., bëj kujdes se shërbimet tuaja do të shpërblehen..., nëse do të mungojë "allishverishi" a bashkëpunimi dhe nëse do të bësh përpjekje ta shpallësh të paqenë urdhëresën time, dije se do thyesh qafën". Se "urdhri i hetuesit (nuk) e paskësh bishtin prapa", fiqiri im prej axhamiu e kuptoi që kur ia çanë kokën!

Një mbrëmje tek po e shkruaja opinionin e radhës, dëgjova zërin urdhërues dhe paksa të ashpër të "indiankës" së shtëpisë sime (siç parapëlqen të thotë "goca" Gordanë). Pa një pa dy, kjo zonja e shtëpisë më thotë "lëre shkrimin..., pa shikoje e dëgjoje si këndon kjo këngëtare". Çështje e vërteta, unë nuk kisha dertin e këngës tallava, isha dalldisur pas "shkarravinës" në fjalë, megjithatë për një moment ktheva shikimin nga televizori dhe pashë një vashë gjysmëlakuriqe. Meqenëse tallavaistja nuk më krijoi asnjë përshtypje, qeshë i detyruar që kësaj gruaje që mbarështon e qeveris shtëpinë, t'i them: "Të lus, më lër rehat... dhe futja!" Sikur asaj iu duk se nuk e përfilla urdhrin e saj, ndaj me inat dhe gojën plot ma ktheu: "... futja ti!" Pas pak kohësh më tha: "Ktheje llafin prapë". "Aha, fjalën pise e mori havaja!". Që unë të mos keqkuptohem, do jap sqarime shtesë sa i përket kësaj vakie. Sikur kjo këngëtare a fundërrinë e pavlefshme, të ishte nga shehri im, mamasë së saj do t'ia kontestoj të drejtën e të qenit edukatore, të drejtën e të qenit amvisë e shtë-



pisë dhe së fundi do t'ia kufizoj të drejtën e të dhënit urdhëresa. Urdhri i zonjës sime ishte shumë i drejtë, pavarësisht se dukej i "rreptë a i padiskutueshëm". Kryesorja, mua më erdhi mirë edhe përkundër "pishmanllëkut" të bashkëshortes sime. E gjithë kjo mesele sikur më thotë se jo gjithmonë urdhri e ka bishtin prapa!, ky "urdhër akshami, mua më doli për hair"..., ndërkaq ata që nuk e kanë ndërmend të pajtohen me mendimin tim ndryshe, le të bëjnë kujdes kur ta hanë preshin nga bishti, sepse po ta përtypësh kërcellin e gjatë e fletë-fletë nga ana e prapme e tij, dije

se punët të dalin "buçuk!"... dhe mua, për fat të mirë, "hesapet më dolën me tamam". Për të tjerët nuk kam habere!

Disa ditë më parë në një "agshol të vonuar", me një "urdhër paraprak dhe të prerë prej sabahut", qeshë i detyruar të "gjezdis" rrugëve të mëhallës sime. Çështje e vërteta, unë jam bërë shumë "çallamxi" dhe kam filluar të "mburrem" me lagjen time që ka shikim nga Sharri, pavarësisht se kjo mëhalla jonë është shndërruar e gjitha në beton, në asfalt, "në art, në teatër, në bibliotekë, në një udhëkryq të rëndësishëm", në një gërmadhë të

Të drejtën e organizimit dhe realizimit të referendumit e ka Komisioni Shtetëror Zgjedhor, partitë politike dhe institucionet e tjera relevante të shtetit, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, konform standardeve, rregulloreve dhe kriterëve të caktuara dhe jo gjithsecili, të cilit si t'i kujtohet dhe kur t'i kujtohet, përfshi këtu edhe autorin e këtij shkrimi...



fshatit të djegur..., një mëhallë që ka marrë "çehren e njeriut të veremosur" (larg qoftë!), në një lagje ku të gjithë të duken të dremitur "sabah e aksham!". Se për çka dola "nuk më kujtohej". Angazhova dyqanxhiun dhe i thashë: Ore, po më kërkoni në shtëpi... dhe andej u dha xhevapi..., ka dalë të blejë bukën e thekërt prej çerepi te furrxhiu nga Hasi i Prizrenit. Te hasjani bukën e blen edhe mësuesi, edhe bujku, edhe me demek "profesori universitar", edhe studenti e nxënësi, edhe beqari edhe lënësja, edhe elektrikisti edhe postieri, edhe intelektualit edhe "heqimi" i pensionuar i lagjes sonë, edhe pasaniku edhe biznesmeni edhe fukarai. "Fatmirësisht" politikani hiç fare nuk duket atypari, sepse ai bukën dhe produktet e tjera ushqimore i blen te dyqanet ekskluzive greke dhe te ca turke! Në kthim e sipër, rrugës më takoi "shef teneqexhiu ose" majstorot za okolu kuqni pishalki" (ullukbërës shtëpish), siç bashkëqytetarët tanë sllav nga Tetova parapëlqejnë ta quajnë. Ishte i përgjumur dhe i tërë hundë e buzë! Me të në shoqëri ishte nipi i ish-berberit të kasabasë sonë, i cili para gjashtë e më shumë dekadash, me "urdhër" të prindërve tanë, që "detyruar" ne kalamajve të na "hiqte

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goca Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e enjte 20 shtator | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

lafshën e organit burrëror". Mirëmëngjesin tim ma ktheu me një "selam" gjysmë anadol-lak. I parashtrova pyetjen: Ç'kemi shef i nderuar teneqexhi, ç'habere kemi nga kooperativa! Çuditërisht, nuk ma ktheu "hazërxehevapin" dhe, lëre që nuk më përshëndeti ashtu siç dua unë, po filloi me atë retorizmin e tij bosh dhe të rëndë. Sikur kacagjelohej para fëmijëve..., sikur muhabetin e filloi kodra mbas bregut! Pyetja e parë e tij kishte të bëjë me privatësinë time: "...pse nuk e merr byrekun me mish, pse nuk e konsumon atë me gjizë, me spinaq, me hithra a me..., pse nuk e merr bukën e grunjte dhe të zezë...", mandej më bëri vërejtje për një shkrim paraprak timin. Nuk i paskësh pëlqyer titulli, përmbajtja, as leksiku, as sintaksa dhe në fund as lektura. Po halli ç'duhet bërë miku teneqepunues, e pyeta! "Bëje një tjetër dhe, pasi ta bësh, mos harro të dalësh në referendumin popullor!" Hajde mendje, hajde! Po kush je ti të më sugjerosh a të më urdhërosh.

"Ore, kam urdhër të politikantit që ia bëra okollu kuqna pishallkat e apartamentit të tij..., krejt veresie!" Sikur vazhdoi të dërdëlliste pas shpine... "Bëj kujdes dhe mos harro se këtë që ta them është URDHËR PREJ SABAHU!"... dhe unë e pyeta: Po sikur të mos e zbatoj këtë "urdhërin tënd prej sabahu" çka do të ndodhë?! Ma ktheu: "Do t'i thyej fulqinjte"... por ama do më bësh një shërbim, para se të m'i thye sh turinjte, të lus të m'i prekësh "topat e kandarit"... dhe ky ustai prej teneqexhiu që u përngjan atyre çunave të Stambollit dhe Kavajës, s'kishte se si ta refuzonte kërkesën time në këmbim të zbatimit të urdhrit të tij! Fatkeqësisht, teneqepunuesi ynë i nderuar bashkë me shoqëruesin e tij nip berberi si dhe ca të tjerë të tillë si ai, asnjëherë nuk bënë dallimet ndërmjet nocioneve të tilla siç janë: "thirrje, bojkot, propagandë, urdhër, organizim dhe realizim". Tekefundit, të drejtën e organizimit dhe realizimit të referendumit e ka Komisioni Shtetëror Zgjedhor, partitë politike dhe institucionet e tjera relevante të shtetit, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, konform standardeve, rregulloreve dhe kritereve të caktuara dhe jo gjithsecili, të cilin si t'i kujtohet dhe kur t'i kujtohet, përfshi këtu edhe autorin e këtij shkrimi, pa marrë parasysh se do të votojë PËR apo KUNDËR ndryshimit të emrit të shtetit, pa marrë parasysh se referendumi apo kjo formë e shprehjes së mendimit të popullit, "e ka bishtin prapa a para hundës!".

Pazari me territore, projekt rus për kontrollin e Ballkanit



Nga
Nijazi IDRIZI

Mungesa e një strategjie për të ardhmen e Kosovës, pajtimin dhe paqen në mes të serbëve dhe shqiptarëve e la në mes të urës së lbrit, ndërsa veriun e Kosovës nën administrimin e Serbisë. Për pasojë Kosova u fut në bisedime komplekse politike e teknike, të cilat vetëm burokratët e pasionuar din ti bëjnë. Më në fund, presidentët Thaçi e Vuçiq e nxorën projektin rus të kontrollit të Ballkanit, për futjen në dorë të dy drejtimit jetike të Kosovës dhe garantimin e radarëve serb që kontrollojnë Ballkanin.

Për ta bërë këtë marrëveshje akt të kryer, (sipas shembullit të demarkacionit me Malin e Zi), nuk është nxjerr në debat asnjë parim e as kriter, që është përdorur për marrëveshje, sepse ka qenë e ditur se cilido kriter që do të përdorej: gjeografik, ekonomik, ushtarak, pronësorë, madje edhe ai etnik, do të ishte në dëm të Kosovës.

KRITERI GJEOGRAFIK

Nga tri drejtimit strategjike të Kosovës, vetëm në veri ndodhen dy (ai i lbrit dhe i Adriatikut). Në dy deceniet e ardhshme kur pritet aktivizimi tyre, ato Kosovën do ta shndërrojnë në intraport (portit tokësor) të Ballkanit. Këtë ia mundëson pozita gjeografike e saj, si qendër nga ku të gjitha kryeqytetet e shteteve janë afër.

KRITERI EKONOMIK

Në këtë pjesë të Kosovës, gjendet resursi jetik i saj: uji i Ujmanit, me 350 milion metër kub ujë, me të cilin, pa prishur asnjë ekuilibër rajonal, mund të përmbushen nevojat aktuale të pothuajse gjithë Kosovës. Nga përvojat e tashme të privatizimit, dyshimet janë se kjo digë mund të jetë objekt i një biznesi të përbashkët Thaçi-Vuçiq. Poashtu, aty janë rezervat sipërfaqësore të disa mineraleve me kosto të lirë shfrytëzimi, të cilat kanë vlerë berzash.

KRITERI I SIGURISË (USHTARAK)

Aty janë dy grykat e sigurisë kombëtare të Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë. Me shumë pak fuqi ushtarake e me kosto të vogël mund të garantohet paqja. Aty poashtu është faqja kosovare e Kopaonikut, nga e cila si në pëllëmbë të dorës vëzhgohet Serbia dhe me kohë denoncohet çdo agresion ndaj cilitdo vend.

KRITERI PRONËSOR

Edhe nëse përdoret kriteri pronësor, prapë Kosova del e humbur, për shkak të mos formalizimit të pronave të shqiptarëve të blera nga serbët, të cilin e ka ndaluar shteti serb për shumë vite, ndërsa shteti i Kosovës nuk ka bërë asgjë për formalizimin e tyre. Në veri të Kosovës, pronat e shqiptarëve i ka blerë shteti serb, ndërsa në Luginë të Preshevës, janë shuar zyrtarisht dhjetëra fshatra për shkak të ligjeve diskriminuese të cilat i shuajnë vendbanimet e braktisura. Tashti, po të përdoret ky kriter, komplet veriu do të takonte Serbisë, ndërsa Kosovës do të kalonte vetëm Presheva dhe më pak se gjysma e Bujanocit.

KRITERI ETNIK (KOMBËTAR)

Me zbatimin e kriterit etnik, gjendja del të jetë edhe më e keqe. Në veri të Kosovës nuk ka shqiptarë. Shqiptarë nuk ka as në Medvegjë, ku aktualisht jetojnë vetëm rreth 400 banorë. Ndërsa edhe në Bujanoc ka pak më shumë se 50% shqiptarë.

Të gjitha këto argumente e vejnë në dyshim qëllimin patriotik të presidentit Thaçi, për ta shpëtuar Luginën e Preshevës nga zhdukja. Veprim patriotik do të ishte sikur, së paku parat e plaçkitura nga ai, për sigurimin e veturave, t'ua kishte kthyer atyre si investim për mbijetesën në këto hapësira dhe të kishte kërkuar reciprocitet për të drejtat e tyre, me serbët e Kosovës.

Mbi të gjitha koha e propozimit ka ngjallur dyshime në opinion, sepse ai ka dal mu në kohën e referendumit në Maqedoni, i cili është jetik sepse vendoset për anëtarësimin e saj në NATO dhe BE. Disa politologë e identifikuan këtë propozim si mesazh rus për dështimin e tij, duke e akuzuar Thaçin se u bëri thirrje shqiptarëve ta bojkotojnë atë, sepse pas bashkimit të Luginës së Preshevës me Kosovën, radha do ti vije edhe Iliridës, me çka Maqedonia do të zhbëhet.

Për ta ndaluar një gjë të tillë, Institucionet dhe qytetarët duhet ti ndërmarrin disa veprime:

Së pari, duhet të ndalohet nga Kuvendi i Kosovës, flirti i Thaçit me Vuçiqin. Temë e bisedimeve në mes të Kosovës dhe Serbisë nuk duhet të jetë as ndarja e as rregullimi i brendshëm i Kosovës, por temat që rregullojnë marrëdhëniet në mes të dy shteteve fqinje.

Tema të vetme të bisedimeve me Serbinë duhet të jenë, ndarja dhe lëvizja e lirë e qytetarëve serb e shqiptarë në territoret e dy shteteve, bashkë me njohjen e dokumentacioni të tyre. Në vend të kësaj, fatkeqësisht, presidentët Thaçi e Vuçiq e nxorën projektin rus të kontrollit të Ballkanit, për futjen në dorë të dy drejtimit jetike të Kosovës dhe garantimin e radarëve serb që kontrollojnë Ballkanin



Presidenti Thaçi në bisedimet me Serbinë, po përdor metodën franceze të aktit të kryer, duke e lënë anash stilin tradicional amerikan të transparencës dhe debati shterues. Shembuj të këqij kanë qenë: demarkacioni i kufirit me Malin e Zi, Asociacioni i komunave serbe, fusnota etj.

Për më keq, me hapjen e bisedimeve për ndarjen etnike të territoreve, Thaçi e ka rihap çështjen e bashkimit të Serbska Krainës me Serbinë. Stërzgjatje e bisedimeve, pa temat për krimet e luftës, për të pagjeturit, për zhdëmtimet, për fondet kontributive të plaçkitura, për kursimet e qytetarëve të plaçkitura nga bankat serbe etj. e ka humanizuar dhe faktorizuar shtetin serb. Tema të vetme të bisedimeve me Serbinë duhet të jenë, ndarja dhe lëvizja e lirë e qytetarëve serb e shqiptarë në territoret e dy shteteve,

bashkë me njohjen e dokumentacioni të tyre. Së dyti, duhet të hapet dialogu i sinqertë me serbët e vendit, duke i afirmuar shqetësimet e tyre.

Në Kosovë në këto vite u dëshmuua se përkundër gjakderdhjes një shekullore, mund të kultivohet bashkëjetesa në mes të serbëve dhe shqiptarëve. Por, bisedimet me serbët e Kosovës u shpërfillën nga oligarkët tanë, edhe pse ato ishin të rëndësishme për zgjidhjen e shumë aspekteve teknike të Pakos së Ahtisarit, përmes zhvillimit të procedurave elastike me të cilat do të zbuteshin mosmarrëveshjet dhe do të mundësonin marrjen e vendimeve me konsensus, duke e relativizuar debatin për fitoren ose humbjen e dikujt. Këtë qasje e kanë prezantuar herë pas here me guxim edhe disa lider serb të Kosovës të cilët oligarkët i kanë shfrytëzuar për tu "faktorizuar" dhe...ka! Me fillimin e bisedimeve me Serbinë përtej Pakos së Ahtisarit, palët e spostuan këtë disponim në Beograd. Në vend të bashkëjetesës ato i nxitën konfliktet me protesta në urë, vrasje, djegie dhe rrënime, Listen serbe të Beogradit, mure mbi rrugë, tren me simbole të urrejtjes.

Së treti, duhet të shtrihet autoriteti i shtetit të Kosovës në të gjithë territorin e vet.

Kjo shtrirje në veri, po pengohet nga oligarkët e të dyja shteteve, të cilët e kanë ngritur perandorinë e krimit dhe po përfitojnë para, me të cilat po e garantojnë mbetjen në pushtet. Atje është mbrojtur krimi përmes kërcënimit të shqiptarëve dhe joshjes së serbëve me autonomi. Spektaklet e herëpashershme, për të prodhuar viktime e heronj, janë luajtur sipas nevojës, sa për ti hedhur hi syve popullit. Së katërti, Kosova bashkë me Shqipërinë, duhet të ndërtoj aleanca miqësie me Maqedoninë dhe Malin e Zi, me projekte të përbashkët, me qëllim që ta detyrojnë hegjemonin serbe të pushoj dhe pastaj ti bëhet ftesë që edhe ajo të bëhet pjesë e këtyre projekteve. Duhet të theksohet fakti se në këto bisedime, rol kontrovers po luan edhe vet Bruksel. Ndërmjetësit e këtyre bisedimeve, për ta begatuar karrierën e tyre politike, po e humbin paanësinë dhe po bëhen avokat, duke propozuar formula të paqëndrueshme të zgjidhjeve, me çka marrëveshjeve po ia humbin dimensionin strategjik dhe po i bëjnë jetëshkurra.

ITALIA E CIGAREVE KONTRABANDË

Nuk janë më vetëm mafiet lokale që nxjerrin fitime nga tregtia e paligjshme e cigareve në territorin italian, por edhe të gjitha ato organizata kriminale, edhe të markës terroriste, të përfshira në fazat e ndryshme të transportit apo të shitjes së produkteve

I favorizuar nga pozicioni gjeografik në mes të Mesdheut dhe nga organizatat kriminale e rrënjësura në territor, Gadishulli Italian është jashtëzakonisht fleksibël dhe i përgatitur për menaxhimin e trafikeve të paligjshme, në gjendje që të ndryshojë me shpejtësi të madhe modalitetet, mjetet dhe vetë produktet e përfshira në kontrabandën e duhanit sipas situatave. Sipas asaj që përcillet nga KPMG-ja në "Project Sun" e tij, Italia në fushën e kontrabandës ka një shpirt përshtatshmërie që nuk haset në vende të tjera. Në fakt, pavarësisht se burimet e paligjshme të duhanit ndryshojnë vazhdimisht, konsumi mbetet i qëndrueshëm në rreth 5.8% të totalit të cigareve të konsumuara.

Kontrabanda e duhanit në Itali ka pësuar një rënie shumë të fortë në fillimvitet 2000, për t'u rritur më pas gradualisht nga viti 2008 dhe për t'u dyfishuar midis viteve 2011 e 2012. Faktikisht, në vitin 2012, me konsumin e 2.8 miliard cigareve, Gadishulli ka arritur vendin e dytë në renditjen e konsumeve të paligjshme europiane, duke u pozicionuar midis Polonisë (4.5 miliard) dhe Greqisë (1.7 miliard), me një rritje çuditërisht të shpejtë. Në vitin 2015 rezultonte se ishte në vendin e pestë për kontrabandën dhe falsifikimin e cigareve, pas Francës, Polonisë, Mbretërisë së Bashkuar dhe Gjermanisë. Edhe falsifikimi ka arritur në fakt nivele shumë të larta në Itali, që në shkallë europiane, bashkë me Mbretërinë e Bashkuara dhe Poloninë, mbulon mbi gjysmën e tregut të këtyre produkteve.

Megjithatë, për momentin, produktet e paligjshme me bazë duhani më të konsumuara në Itali janë të ashtuquajturat illicit whites, cigaret marka të taksuara



vetëm për konsum lokal, që eksporthen ilegalisht në vende të tjerë dhe shiten aty me çmime jashtëzakonisht të ulëta. Vendet kryesore furnizuese të cigareve të paligjshme në Itali, por edhe në vende të tjera të Europës Perëndimore, janë ato të Lindjes europiane, për shkak të fitimeve të mëdha që mund të nxirren duke shfrytëzuar diferencën e çmimit të pake-tave në shtete të ndryshme. Realisht, produktet me bazë duhani kanë në Ukrainë, në Poloni, në Bjellorusi dhe në shtete të tjera të Europës Lindore çmime jashtëzakonisht të ulëta krahasuar me mesataren europiane. Shitja e mallrave të paligjshme me një çmim të fryrë (gjithsesi më i ulët se ai i cigareve të ligjshme) në vende si Gjermania, Italia, Franca apo Anglia garanton kështu fitime të majme. Veç kësaj, kriminaliteti europianolindor ka nisur të lidhë raporte të natyrës tregtare me mafiet tona menjëherë pas rënies së Murit të Berlinit, duke eksperimentuar rrugë dhe modalitete që ndër vite janë konsoliduar gjithnjë e më shumë, duke arritur edhe një aftësi të habitshme në shmangien e kërcënimeve të organeve të kontrollit.

Për më tepër, kontrabanda e

duhanit demonstron jashtëzakonisht komode, pasi krahasuar me trafike të tjera të paligjshme, ofron avantazhe të ndryshme: kontrolle më të rralla dhe më pak të rrepta. Megjithatë, të ardhurat e siguruara nga një krim më i lehtë si si ai i kontrabandës shpesh përkthehen në financime të ripërdorshme në trafike të tjera më të rënda, si trafiku i qenieve njerëzore, i armëve apo i drogave, përveçse në aktivitete terroriste në kuptimin e vërtetë të fjalës.

Markat më të njohura të futura në rrethin ilegal italian janë Marlboro, Pall Mall dhe Winston. Përqindja e lartë e kontrabandës e markave të famshme në Napoli, e regjistruar në Report 2017 e Intellegjit, e bën ndoshta qytetin nga ku vijnë këto cigare dhe nga ku përhapen në ekstremitetet e Gadishullit. Edhe illicit whites Regina, American legend dhe Em@il janë tejet të pranishme në territorin napolitan, por janë të përhapura edhe në Bari, Palermo e Milano. Ka shumë të ngjarë që Napoli të ketë një rol qendror edhe në importimin dhe në transportimin e illicit whites. Në fakt është vlerësuar se vetëm në krahinën e Campania, e vënë në kontrollin e drejtpërdrejtë të Camorra, është përqëndruar 33% e



Për momentin, produktet e paligjshme me bazë duhani më të konsumuara në Itali janë të ashtuquajturat "illicit whites", cigaret marka të taksuara vetëm për konsum lokal, që eksporthen ilegalisht në vende të tjerë dhe shiten aty me çmime jashtëzakonisht të ulëta

kontrabandës italiane.

Grupet kriminale e përfshira në trafikun e duhanit janë për më tepër të lidhura me shoqatat mafioze e Sacra Corona Unita puljeze dhe të Camorra napolitane, por edhe të 'Ndrangheta kalabreze apo të Mafies siçiliane. Veç kësaj, nëntoka kriminale ka kontakte konstante me grupe kriminale të përtejdetit, si të vendeve të zonës ballkanike, ashtu edhe të Mbretë-



risë së Bashkuar.

Në të vërtetë kontrabanda ka marrë një konotacion të dukshëm biznesor në nivel transkombëtar që mundëson të kontrollohet dhe të ndiqet çdo fazë e procesit falë përfshirjes së grupeve kriminale me shtetësi të ndryshme. Në mënyrë të veçantë, Camorra ruan kontakte konstante me kriminaliteti kinez, që merret edhe me falsifikim, dhe me atë rumun. Shumë prej produkteve të paligjshme të prodhuara në Kinë, pasi janë nisur nga portet e Shenzhen, Huangpu apo Xiamen, kalojnë nëpër Dubai dhe përgjithësisht zbarkojnë në portin kalabrez të Gioia Tauro. Edhe kriminaliteti shqiptar i përfshirë në kontrabandën e duhanit, sipas të dhënave të furnizuara nga Direzione Nazionale Antimafia në vitin 2015, është ende në rritje në Itali, duke ecur në të njëjtin hap me rritjen demografike dhe shpërndarjen kapilare në territor. Janë të përfshirë në trafikun e kontrabandës edhe grupe kriminale me shtetësi bullgare e georgjiane, aktivë sidomos në zonat më të pasura të Italisë qëndroveriore, sidomos në Romë e Milano, dhe në Bari e rrethinat e tij.

Evolucioni i rrjeteve të reja dhe të ndërlikuara të organizatave kriminale, dikur të lidhura fuqimisht me kontrollin e territorit dhe me strukturën hierarkike, e bën krimin më depërtues, përveçse shumë më funksional dhe të përshtatur me trafiket e paligjshme me vende edhe gjeografikisht të largëta. Perfeksionimi i kohëve të fundit dhe progresiv i mafieve ndaj kësaj forme të re biznesi ka bërë të mundur një zgjerim të tregut, duke arritur që të asgjësojë ata kufij midis grupeve kriminale që normalisht i mendojnë si thujse fizikisht ekzistues. Në fakt, pavarësisht se kanë mbetur, të paktën pjesërisht, të lidhura me kontrollin territorial, organizatat mafioze nuk e kanë më një tipar dallues absolut dhe të pandryshueshëm: në emër të një interesi ekonomik, grupet e ndryshme arrijnë që të bashkëpunojnë duke vendosur marrëdhënie të tipit ekonomik, duke kushtëzuar njëri tjetrin dhe duke modifikuar një sistem të tërë në nivel ndërkombëtar.

Grupet kriminale, jo më kaq pastër të dallueshëm si në gjysmën e parë e shekullit të kaluar, po adoptojnë një qasje të globalizuar, duke shkurtuar largësitë dhe duke shumëfishuar fitimet. Nuk janë më vetëm mafiet lokale që nxjerrin fitime nga tregtia e paligjshme e cigareve në territorin italian, por edhe të gjitha ato organizata kriminale, edhe të markës terroriste, të përfshira në fazat e ndryshme të transportit apo të shitjes së produkteve. (bota.al)

Për të kuptuar se si kultivimi i frutave, mund të çojë në lindjen e krimit të organizuar, duhet të kthehemi edhe më pas në kohë, në kushtet që mbizotëronin në Marinën Mbretërore Britanike në shekullin XVIII-të. Para viteve 1800, marinarët që ishin pjesë e udhëtimeve në distanca të gjata në të gjithë botën prekeshin rëndom nga skorbuti, një sëmundje e shkaktuar nga mungesa e vitaminës C

Nga Ola OLSSON

FILLIMET E MAFIAS

LIMONËT QË SOLLËN LINDJEN E COSA NOSTRAS



sëmundjes humbjen e dhëmbëve, shqetësimet emocionale, ethet dhe konvulsionet. Shkalla e vdekshmërisë, gjatë udhëtimeve në distanca të gjata ishte zakonisht e lartë. Asokohe, askush nuk kishte njohuri sistematike mbi atë që e shkaktonte skorbutin, edhe pse ishin nxjerrë disa njohuri rastësore. Më pas, në mesin e viteve 1700, Xhejms Lind, një mjek skocez në Marinën Mbretërore, kreu studimet e para klinike tek marinarët e sëmurë. Një grupi kontrolli, iu dha ushqimi i zakonshëm që shërbehej në anije, ndërsa një grup i vogël u ushqye me fruta të freskëta.

Pa dyshim, grupi i dytë u bë më mire, dhe Lind i botoi gjetjet e tij në "Një traktat mbi skorbutin" (1753). Megjithatë, ai studim u injorua në masë të madhe deri në vitet 1790, kur komisionarët e sëmurë të Marinës Mbretërore, filluan të rekomandonin shërbimin e lëngut të limonit për të gjithë flotën. Pasi njohja e efekteve të dobishme të agrumeve u përhap nëpër Evropë, limonët u bënë një mall gjithnjë e më i çmuar. Ishulli i Sicilisë, ishte një ndër rajonet e pakta në botë që mund të plotësonin kërkesën për limona të freskët. Limoni dhe

agrumet e tjera, qenë sjellë në Sicili nga arabët që në shekullin X.

Megjithatë, për shkak të ndjeshmërisë së tyre ndaj ngricave, limonët mund të rriteshin vetëm në vende të caktuara, zakonisht pranë vijës bregdetare. Para shekullit XIX, limonët përdroreshin kryesisht për dekor dhe prodhimin e parfumeve. Rekomandimet e komisionarëve të sëmurë në Britani, ndryshuan gjithçka. Në dekadat e ardhshme, një pjesë e madhe e prodhimit bujqësor sicilian, u riorientua drejt prodhimit të agrumeve për tregun ndërkombëtar. Megjithatë, kalimi tek kultivimi i limonëve në shkallë të gjerë, nuk qe një proces i shpejtë apo i lehtë. Vetëm zona të caktuara të ishullit ishin të përshtatshme, madje edhe ato kërkonin shumë para për kultivimin. Fermerët e limonit, përdorin zakonisht puset për të ujitur bimët të paktën një herë në javë. Për të mbrojtur pemët nga hajdutët dhe erërat e forta, pemët ishin shpesh të mbrojtura nga mure dhe gardhe të lartë. Pemët e pambrojtura me limona të pjekur, ishin zakonisht një objekt i lehtë për hajdutët.

Disa vite investimesh, mund të shkatërrohen lehtësisht nga gra-

bitësit, duke u vjedhur brenda një nate të vetme të errët. Prandaj, në mesin të viteve 1800, kur të ardhurat e eksportit filluan të kapin shifra të jashtëzakonshme, pemët nisën të mbrohen me roje të armatosura. Mes viteve 1837-1850, numri i fuçive me limon të eksportuara nga porti sicilian i Mesinës në vende të ndryshme të botës, deri në SHBA, u rrit nga 740 në 20.707. Bumi i kërkesës për agrume, u solli fitime marramendëse mëdha kultivuesve të limonit në Sicili. Por kush ishin këta fermerë, dhe në çfarë lloj kushtesh po punonin? Në gjysmën e parë të shekullit XIX, Sicilia karakterizohej nga institucione të brishta publike dhe një sundim i dobët i shtetit ligjor. Banditët bënë ligjin nëpër fshatra, dhe vjedhja dhe varfëria e rrënuan popullatën. Rrënjët e këtyre problemeve, shtriheshin tek pushtimi shekullor nga disa fuqi të huaja.

Më në fund në vitin 1861, Sicilia u pushtua nga trupat italiane nga kontinenti, dhe u bë pjesë e Mbretërisë së sapa-formuar italiane. Kryeqyteti faktik ndodhej në Piemonte, në veriun e largët. Shpejt u bë e qartë, se shumë sicilianë ishin të pakënaqur me marrëveshjen e re. Italianët e gadishullit, flisnin një dialekt që sicilianët mezi e kuptonin, dhe në sytë e tyre shteti i Piemontes, ishte thjesht një tjetër fuqi e huaj, që po përpiquej të impononte vullnetin e saj ndaj ishullit të pazhvilluar. Nën atë mjedis, me përzierjen toksike të institucioneve të dobëta qeveritare dhe hyrjeve të mëdha të parave të gatshme nga industria e limonit, u shfaq fillimisht organizata e njohur si mafia.

Fjala mafioz rrjedh nga arabishtja, që do të thotë "mashtues"

ose "tradhtar". Por në Sicili, ky term nuk kishte një domethënie negative. Përkundrazi, ai kishte parasysh dikë që meritonte respekt, pasi ngrihej në emër të popullatës lokale kundër hajdutëve dhe milicive të paligjshme, që mësytin nëpër fshatrat dhe kërcënonin fermerët. Pronarët e tokave, nisën të angazhonin grupe lokale të këtyre njerëzve të forte, për të mbrojtur pemët me shumë vlerë të limonit. Njëherazi, kjo "mbrojtje" merrte nganjëherë karakterin e zhatjes, dhe ishte pak a shumë e detyruar për çdo kultivues agrumesh.

Shembulli i parë i regjistruar i një mbrojtje të tillë "të padëshuar", vjen në vitin 1872, lidhur me njëfarë Dr.Galati, një pronar që kishte një fermë limonësh jashtë Palermos. Menjëherë sapo bleu fermën, Galati mësoi se kujdestari i saj i kishte vjedhur fruta nga pemët, dhe kishte mbajtur për vete një pjesë të madhe të të ardhurave nga vjelja e limonëve. Galati e shkarkoi menaxherin dhe punësoi një zëvendës, por jo shumë kohë pas kësaj ngjarjeje, kujdestari i ri u qëllua për vdekje. Hetimi i policisë nuk e zbuloi dot autorin. Së shpejti nisën të vinin letra kërcënuese, që kërkonin që Galati të rikthente në detyrë kujdestarin e mëparshëm. Refuzimi u pasua nga një seri atentatesh ndaj tij, që e detyruan doktorin të largohej përfundimisht nga ishulli. Incidenti i Galatit, tregon se si grupet e "burrave të nderit", të njohur si "cosca", kishte arritur të infiltrohej jo vetëm në fshatrat e zonës, por edhe tek policia, politika dhe me gjasë edhe tregjet e ndryshme që rrethonin dhe mbështesnin industrinë e agrumeve.

"Cosca" ishin grupe sekrete, anëtarët e të cilëve betoheshin të heshtnin mbi organizimin dhe aktivitetet e tyre, dhe së shpejti do të kontrollonin pjesë të rëndësishme të zinxhirit të furnizimit me limona. Pavarësisht të metave në ambientin kaotik të Sicilisë së asaj kohe, mafiozët lokalë preferoheshin shpesh ndaj përfaqësuesve të shtetit represiv italian. Në fund të vitit 1900, ekonomia siciliane u godit nga stanjacioni ekonomik. Industria e limonit u përball me një konkurrencë të ashpër nga pemët e reja të agrumeve në Florida të SHBA-së. Për pasojë, dhjetëra mijëra sicilianë të varfër emigruan në Shtetet e Bashkuara. Kjo valë emigrimi solli në SHBA jo vetëm sicilianët, por edhe mafien.

Grupe mafioze u krijuan së shpejti në lagjet e varfra italiane në qytetin e Nju Jorkut, dhe u përhapën në qytete të tjera si Boston dhe Çikago. Mafiozët sicilianë u përzien me italianët e jugut dhe grupet kriminale nga etni të tjera, për të formuar variantin e veçantë të mafies amerikane. Ndërkohë, në Itali, mafia siciliane, së bashku me Kamorrën në Napoli dhe Ndrangetën në Kalabri, mbeten edhe sot një kërcënim i madh për sundimin e ligjit. (bota.al)



TË BASHKUAR DREJT KRIZËS

Partitë politike shqiptare, si nga pushteti ashtu edhe opozita, nuk kanë arritur të vendosin një komunikim dhe koordinim të punës me deputetët e Listës Serbe, votat e të cilëve, në shumë raste do të ishin vendimtare për vendimmarrje. Afërsia e kësaj Liste me politikën zyrtare të Beogradit, i mbanë në distancë subjektet politike shqiptare

Institucionet e Kosovës janë duke zhytur në një krizë të thellë institucionale, nga e cila vërshtirë se mund të dalin për një kohë të gjatë. Kështu thonë njohësit e zhvillimeve politike dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare. Naim Rashiti, drejtor i Grupit Ballkanik për Politikë në Kosovë, duke folur për Radion Evropa e Lirë, thekson se kriza në të cilën është Kosova dhe që mund të zgjerohet, mund të ketë pasoja afatgjata për shtetndërtim. "Është një sinjal i një krize të thellë, e cila mund të ketë pasoja edhe afatgjate jo vetëm afatshkurtër dhe pasoja të cilat do të jenë edhe vështirë të menaxhueshme. Unë mendoj që nëse nuk ka një koordinim në këta dy muajt e ardhshëm se si të menaxhohet procesi i dialogut me Serbinë dhe procese të tjera të reformave dhe marrëdhënieve politike, do të kemi një situatë të tensionuar dhe një situatë ku edhe veçjemi kur gjithnjë dhe me shumë po mendohet me kokën dhe idenë për agjendën zgjedhore, se sa me agjendën e temave të rëndësishme, për çka edhe duhet përgatitur dhe tejkaluar", tha Rashiti.

Edhe analisti Albert Krasniqi nga Instituti Demokratik i Kosovës, konsideron se institucionet dhe drejtuesit e tyre bashkë me liderët politikë, janë duke e dërguar Kosovën drejt një krize të thellë. Ai thotë se për të ndaluar këtë të keqe për Kosovën duhet një koordinim i ngushtë ndërmjet gjithë spektrit politik. "Shihet se jemi duke shkuar drejt një thellimi të krizës, nëse



NË TAKIMIN E BRUKSELIT DISKUTOHET PËR LUGINËN

Ndonëse ende nuk dihet saktësisht se kur do të zhvillohet takimi i radhës në kuadër të fazës finale të dialogut Kosovë - Serbi është bërë e ditur se në këtë takim ndër të tjera do të flitet edhe për kërkesën e shqiptarëve të Luginës së Preshevës për bashkim me Kosovën. Këtë e ka pohuar Zyra e Presidentit të shtetit, Hashim Thaçi, ku përmes një përgjigjeje dhënë "Zërit" është thënë se në këtë takim do të bisedohet edhe për modalitetet rreth arritjes së marrëveshjes obliguese ligjore mes dy shteteve.

nuk reflektojnë partitë në pushtet, që t'i realizojnë kërkesat e opozitës. Kuvendi do të jetë i paralizuar, nuk do të mund të marrë vendime në përbërjen aktuale të cilën e ka. Edhe protesta e thirrur nga Vetëvendosje mund ta shtojnë presionin ndaj qeverisë. Kështu që zgjedhjet janë një opsion i cili do të duhej të konsiderohej seriozisht. Në këtë konstalacion politik nuk mund as të merret vendimet e mëdha, as që Kosova të dalë mirë në procesin e dialogut me Serbinë, pa pasur një koordinim ndërmjet institucioneve", tha Krasniqi.

Rashiti shpreh mendimin se problemi qëndron në brendinë e koalicionit qeverisës, brenda partive politike opozitare dhe po ashtu mes koalicionit qeverisës dhe opozitës. "Janë tri lloje të problemeve, përfshirë këtu edhe marrëdhëniet shumë delikate të gjithë akterëve me presidentin (Hashim Thaçi). Ky kompleks i marrëdhënieve të këqija po e bën shumë të vështirë koordinimin. Unë mendoj se prapë iniciativat duhet të vijnë nga qe-

ria dhe partitë në pushtet, të cilat duhet të vijnë me një ofertë serioze për partitë opozitare, për të punuar në temat që janë përtej agjendës qeveritare", tha Rashiti.

Krasniqi mendon se tash për tash nuk ka asnjë gjë pozitive, veç një procesi të ri zgjedhor, që ndoshta mund ta ndryshojë gjendjen. "Nëse bazohemi në sjelljet e partive politike deri më tani, asnjë proces i madh nuk ka mundur të shtyhet përpara pa u paguar me çmimin e zgjedhjeve. I ngjashëm ka qenë rasti me demarkacionin. Të njëjtit akterë politikë vetëm ndërjuan qëndrimet pas zgjedhjeve. Kështu që shumë lehtë mund të ndodhë edhe tani që në këtë përbërje në këtë tensionim dhe polarizim të skenës politike, është shumë e vështirë të imagjinohet një konsensus dhe për t'i parë të gjitha palët duke bashkëpunuar. Kështu që, zgjedhjet mund të jenë një mundësi për të bërë një rikonfigurim të skenës politike", tha mes tjerash Krasniqi. Bllokada e vendimmarrjes në Kuvend ka

Se do të diskutohej për Luginën e Preshevës ishte thënë edhe para takimit të fundit, i cili u mbajt në fillim të muajit shtator, porse një gjë e tillë nuk kishte ndodhur. Ndërkohë, pos opozitës që tashmë po i kundërshton në vazhdimësi idetë e Thaçit rreth dialogut, edhe përfaqësues të Nismës Socialdemokrate nuk po e mbështesin paralajmërimin e presidentit për korrigjim të kufirit, anëtarë të lideri i këtij subjekti, Fatmir Limaj, është caktuar udhëheqës i ekipit të formuar nga Qeveria për bisedimet me Serbinë.

nisur që nga fillimi i mandatit të këtij institucioni. Por, kohët e fundit, ndasitë duket se kanë paralizuar tej mase organin më të lartë ligjvënës në Kosovë.

Aktualisht, në Kuvendin e Kosovës, partitë në pushtet kërkojnë që Kuvendi të emërojë ekipin negociator për dialogun me Serbinë të propozuar nga Qeveria, kurse opozita kërkon miratimin e një Rezolute lidhur me angazhimet e presidentit Hashim Thaçi për përfshirjen e "shkëmbimit të territoreve" apo "korrigjim të kufijve" në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë. Partitë politike shqiptare, si nga pushteti ashtu edhe opozita, nuk kanë arritur të vendosin një komunikim dhe koordinim të punës me deputetët e Listës Serbe, votat e të cilëve, në shumë raste do të ishin vendimtare për vendimmarrje. Afërsia e kësaj Liste me politikën zyrtare të Beogradit, i mbanë në distancë subjektet politike shqiptare. Legjislatura e gjashtë e Kuvendit të Kosovës po përballlet në vazhdimësi me mungesë të kuorumit. (REL)

"SHBA, PRO THAÇIT E VUÇIÇIT"

SHBA mbështet presidentët e Serbisë dhe Kosovës në përpjekjet për gjetjen e një zgjidhjeje paqësore të mosmarrëveshjes mes tyre por mbështet edhe qëndrimin e sheshe për politikën e jashtme në BE Federika Mogherini. Kjo, sipas ambasadorit amerikan në Beograd, Kyle Scott. Në një konferencë për sfiat e sigurisë në Ballkan, në kryeqytetin serb, ambasadori tha se ekzistojnë tre çështje kritike

në rajon; dialogu Kosovë-Serbi, mosmarrëveshja për emrin e Maqedonisë dhe mbajtja e Bosnjë-Hercegovinës, shtet. Sipas Scott, këto probleme nuk janë të pazgjidhshme, çka shihet me atë që po ndodh në Maqedoni. Në Bosnjë përparimi nuk është i shpejt ndërsa në Beograd dhe Prishtinë, po shihen lëvizje të reja. "Shpresojmë që një zgjidhje e pranueshme dhe e qëndrueshme do të gjendet shpejt", tha Scott.



Kroacia e aftë t'i kontrollojë kufijtë e vet

Policia kroate është e aftë vetë t'i kontrollojë kufijtë e vet dhe nuk i nevojitet ndihmë plotësuese nga Agjencia evropiane për kontroll kufitar - Fronteks, deklaroi mbrëmë në Salsburg kryeministri kroat, Andrej Plenković. "Bashkëpunimi ynë me Fronteksin është i shkëlqyeshëm. Aeroplani i tyre nga Zara e kontrollon tërë hapësirën e juglindjes evropiane. Sa i përket forcave të Fronteksit që duhet të shkojnë në juglindje të Evropës, ne mendojmë se ato duhet të sistemohen në ata kufij të jashtëm ku ka lëshime më të mëdha (të emigrantëve)", deklaroi Plenković, i cili në Salsburg po merr pjesë në Samitin e BE-së. Komisioni evropian propozoi plan me të cilin parasheh përfundim të kontrollit të kufijve të jashtëm të BE-së me sistemin e një numri plotësues të pjesëtarëve të Fronteksit. Megjithatë, sipas Plenković, Kroacisë nuk i nevojitet ndihmë plotësuese nga Fronteksi, kështu që propozon pjesëtarët e Agjencisë "t'i përforcojnë ato vende ku lëshimet janë më të mëdha". Kroacia ka kufij të jashtëm të BE-së drejt Serbisë, Bosnjë e Hercegovinës dhe Malit të Zi.

Ushtri pa buxhet



Qeveria e Kosovës ka planifikuar të bëjë ushtri që nuk prek në kuletë të shtetit. Mbështetur në projektionet e bëra, avancimi i statusit të Forcës së Sigurisë (FSK) nuk do të ketë asnjë implikim buxhetor. E dhëna ndodhet në deklaratat financiare të tri projektligjeve që i ka miratuar ekzekutivi javën e shkuar, e me të cilat synohet që FSK-ja të ngrihet në ushtri. Të tria deklaratat, "Koha Ditore" i ka siguruar të mërkurën. Janë përgatitur nga Departamenti i Buxhetit, që funksionon në kuadër të Ministrisë së Financave dhe kanë përmbajtje thujse identike. Në përfundimet e këtyre deklaratave konsiderohet se për zbatimin në praktikë të aktiviteteve që dalin nga këto projektligje është i mjaftueshëm buxheti i projektuar në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, që i referohet periudhës 2019-2021, por edhe në Qarkoren buxhetore përkatëse. Bazuar në këto dokumente, në tre vjetet e ardhshëm, për FSK-në do të alokohen rreth 174 milionë euro.

Suedia është shembulli më i ri. Më fillimin e krizës së refugjatëve, gati në të gjitha zgjedhjet në vendet e BE-së kanë fituar terren të madh partitë populiste të djathta. Në disa vende ato madje bashkëqeverisin

- Itali. Shokëve të idealit, ministri i Brendshëm italian, Matteo Salvini i uroi gjithë të mirat për votimet. Në Itali partia e tij "Lega Nord" është politikisht shumë më përpara se Demokratët Suedezë. Lega Nord vërtet që zuri vendin e tretë në zgjedhje, por bashkë me lëvizjen "Pesë Yjet" ajo u fut në koalicion si partneri më i vogël. Që atëherë, Salvini sundon skenën politike europiane me një politikë të fortë kundër të huajve, ai është aq prezent, sa madje disa e mbajnë atë për kreun e qeverisë. Gjuha e tij nxitëse dhe politika kundër të huajve gjejnë rezonancë. Gati 100 ditë pas hyrjes në koalicion, Lega Nord ndodhet në krye të sondazheve me 30%. Kujtojmë se në zgjedhje ajo arriti vetëm 17% të votave. Në drejtim të Merkelit, Salvini tha se ajo "nënvleftësoi rrezikun e konflikteve sociale, kur

EUROPA PO KTËHEHET DJATHTAS



mendoi se kishte vend për qindra mijë njerëz në Gjermani".

- Austri. Partia populiste austriake e lirisë, FPÖ ka pasur përvojë qeverisëse më të gjatë. Në vitin 1999, kjo parti doli partia e dytë më e fortë në zgjedhjet e atëhershme parlamentare, dhe krijoi një koalicion me ÖVP. Tani po kjo aleancë qeveris nga viti i kaluar me kancelar, Sebastian Kurz. Por FPÖ nuk duhet të luftojë shumë për një kurs të fortë në politikën e azilit. Sebastian Kurz vetë u zhvendos

djathtas me politikën e tij për të mbajtur refugjatët larg Austrisë. Por FPÖ shkon edhe një hap më tej. Ministri i Brendshëm, Herbert Kickl kërkon t'i mbajë refugjatët "të përqendruar", gjë që solli reagime të forta dhe akuzën se ai po përdor gjuhën e nacionalsocializmit.

- Gjermani. Në zgjedhjet e Bundestagut në shtator 2017, Alternativa për Gjermaninë, AfD arriti 12,6 të votave dhe me 94 vendet në Bundestag është partia e tretë

më e fuqishme, dhe partia më e madhe opozitare. Miratimi për këtë parti vazhdon të rritet. Në sondazhet e fundit kjo parti ka arritur 15% të votave, dhe nganjëherë ajo arrin të kalojë vetë Partinë Socialdemokrate. Në disa sondazhe në Lindje AfD madje kryeson, duke kaluar edhe partinë CDU. Edhe pse ekspertët e politika e akuzojnë këtë parti për afrimet me ekstremistët e djathtë dhe kërkojnë që të vëzhgohet nga Mbrojtja Kushtetuese, duket se asgjë nga këto nuk e ka dëmtuar AfD-në. Së fundmi kjo parti pritet të hyjë edhe në dy parlamentet e fundit të landeve në Bavari më 15 tetor dhe në Hesen më 28 tetor.

- Francë. Kur Marinë Le Pen nga Front National doli në raundin e dytë për ballë Emmanuel Macron, shumë vëzhgues kishin theksuar se bëhej fjalë as më pak e as më shumë, por për të ardhmen e Europës. Proeuropiani Macron fitoi dukshëm përballë Marine Le Pen 66% kundrejt 34%. Prej atëherë duket sikur Le Pen doli nga skena, në fund ajo arriti të ndërrojë emrin e partisë në Lëvizja Kombëtare e Përgjithshme. Por shumë përkrahës presin që mbesa e Le Pen,

Marechal Le Pen të marrë timonin për ta arritur me të fitoren. Megjithatë edhe në Francë armiqësia ndaj të huajve dhe skepticizmi ndaj Europës janë bërë pjesë normale.

- Holanda. Para zgjedhjeve parlamentare në Holandë në mars 2017, në të gjithë Europën sundonte paniku mes partive tradicionale se çfarë rezultati do të arrinte Partia e Lirisë PVV e Geert Wilders. Rezultatet treguan kjo parti nuk doli triumfuese, por me rezultatin 13%, kjo parti zuri vendin e dytë, ndërkohë që socialdemokratët gati u shuan politikisht. Pas koalicionesh të vështira u arrit më në fund të krijohej një aleancë e qendrës më të djathtë. Por Wilders me qëndrimin e tij refuzues ndaj emigrantëve dhe islamit vazhdon të sundojë skenën politike në Holandë. Ndërkohë me Thierry Baudets është krijuar një parti tjetër e ekstremit të djathtë që ndjek qëllime identike si Wilders. Baudet paraqitet si njeri i kulturës, luan piano dhe flet latinisht, duke iu drejtuar kështu shtresës së arsimuar. Kështu djathtistët nuk do i marrin vota njëri-tjetrit, por më shumë do t'i shumojnë ato.

Publicitet

FONDE EVROPIANE PËR MAQEDONINË EVROPIANE



Ndihma totale vjetore e BE-së për Maqedoninë është 90 milion euro, respektivisht 260.000 euro në ditë.

Hyjmë në Union prej 500 milion konsumatorëve ose treg 250 herë më të madh se tregu vendor.

15.5 milion euro vjetore për Maqedoninë nëpërmjet Programës së BE-së për transport (fonde me të cilat ndërtohen rrugë, ura, hekurudha, tunele dhe infrastrukturë tjetër).

8.5 milion euro mjete evropiane për mbrojtjen e kufijve të Maqedonisë për vitin 2018.

15 milion euro mjete evropiane për bujqit në Maqedoni për vitin 2019.

18 milion euro në vitin 2020 për reformat në gjyqësor dhe policinë e Maqedonisë.

Me 30 shtator!

DIL PËR MAQEDONI EVROPIANE!



Nga Qerim LITA

DIBRA E MADHE GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE (1)

“GJUHA ASHT TAPIA E VENDIT”

Me kapitullimin e Mbretërisë jugosllave (prill 1941), tokat shqiptare nën pushtimin e asaj mbretërie u ndanë në tri zona pushtuese: Zona pushtuese italiane; Zona pushtuese bullgare dhe Zona pushtuese gjermane. Dibra e Madhe së bashku me pjesën dërmuese të rretheve: Tetovë, Gostivar, Kërçovë dhe Strugë, i takuan Zonës pushtuese italiane. Rrjedhimisht, në Dibër u formua “Komiteti Shqiptar”, anëtarë të të cilëve ishin: Sherif Langu, Osman Piperku, Daut Imami, Nuri Shehu, Osman Rusi, Ali Maliqi, Hysni Dema, Sabri Maqellari, Uke Saliu, Uke Cami etj. Ky Komitet shtroi disa objektiva para vetes, si p.sh. bashkimin e viseve shqiptare me Shtetin shqiptar, krijimin e organeve të pushtetit shqiptar; civil e gjyqësor në viset e çliruara, hapjen e shkollave shqipe në Dibër e rrethinë, forcimi i vetëdijes shqiptare ndër shqiptarët e këtij krahu etj..

Më 29 qershor 1941, Qeveria italiane solli vendim, me të cilin qeverisë shqiptare iu dha e drejta e ushtrimit të pushtetit civil për “viset e Kosovës, Dibrës dhe Strugës”. Për rrjedhojë, qeveria shqiptare më 8 korrik emëroi Fejzi Alizotin ministër Shteti, përkatësisht komisar i Lartë Civil, për “ushtrimin e pushtetit civil në Kosovë, Dibër e Strugë”, me qendër në Prizren. Në fillim të muajit gusht, Komisariati i Lartë Civil, Dibrën e Madhe e shpalli qendër administrative të Qarkut, përkatësisht Prefekturës, në kuadër të së cilës u përfshinë 5 nënprefektura: Nënprefektura e Tetovës, Nënprefektura e Gostivarit, Nënprefektura e Kërçovës, Nënprefektura e Rekës dhe Nënprefektura e Strugës. Krahas prefekturave dhe nënprefekturave, administrimi civil lokal ushtrohej edhe nga bashkitë (komunat urbane) dhe komunave rurale, numri i të cilave në Prefekturën e Dibrës arrinte shifrën prej 51, prej tyre 5 bashki (Dibër, Tetovë, Kërçovë, Gostivar dhe Strugë) dhe 46 komuna rurale, me një sipërfaqe prej 4.070, në të cilën jetonin gjithsej 237.204 banorë.

Organet administrative të Prefekturës së Dibrës filluan me punë nga fundi i gushtit dhe fillimi i shtatorit të vitit 1941, por marrë në përgjithësi - ata ishin ende të pakonsoliduara plotësisht. Kështu p.sh. gjyqet jugosllave përfundimisht qenë suspenduar me Urdhrin e 28 tetorit të vitit 1941, kurse gjyqet oficiale shqiptare filluan me punë nga 4 maji i vitit 1942. Organet e rendit ishin xhandarmeria (karabinierët) dhe policia (kuesturat). Xhandarmeria komandohej nga italianë, kurse policia komandohej nga shqiptarë. Ndërkaq, gjuhë zyrtare në administratë ishte gjuha sh-

Bashkimi i pjesës më të madhe të tokave shqiptare me Shqipërinë, u prit me një entuziazëm të lartë nga popullsia shqiptare, e cila këtë bashkim edhe pse erdhi si rrjedhojë e interesave strategjike të shteteve të Boshtit, e konsideronte si çlirim kombëtar. E gjithë kjo ishte si rrjedhojë e politikës diskriminuese nga ana e pushtuesit serb. Ky diskriminim kishte arritur deri në ato përmasa sa që të shqiptarët ishte krijuar bindja se cilido pushtues që të vij, nuk mund të jetë më i egër se ai serb, apo siç thuhet në një dokument ushtarak jugosllav: “le të vijë edhe dreqi i mallkuar, do të jetë më mirë se kështu”

qipe. Në territorin e prefekturës së Dibrës u vendosën një numër i forcave xhandarmerie (karabinierët) - rreth 1500 sish. Ndërkaq, selia e formacionit policor (kuesturave) të kësaj prefekturë ishte në Dibër, kurse degët ishin nëpër selitë e nënprefekturave. Efektiva të xhandarmerisë ishin sistemuar në të gjithë territorin e kësaj prefekturë, dhe atë: nëpër bashkitë e qyteteve nga 20-30 xhandarë, kurse nëpër fshatra qarkullonin nga 4-5 xhandarë.

Bashkimi i pjesës më të madhe të tokave shqiptare me Shqipërinë, u prit me një entuziazëm të lartë nga popullsia shqiptare, e cila këtë bashkim edhe pse erdhi si rrjedhojë e interesave strategjike të shteteve të Boshtit, e konsideronte si çlirim kombëtar. E gjithë kjo ishte si rrjedhojë e politikës diskriminuese nga ana e pushtuesit serb. Ky diskriminim kishte arritur deri në ato përmasa sa që të shqiptarët ishte krijuar bindja se cilido pushtues që të vij, nuk mund të jetë më i egër se ai serb, apo siç thuhet në një dokument ushtarak jugosllav: “le të vijë edhe dreqi i mallkuar, do të jetë më mirë se kështu”. Shumë familje nga Dibra e Madhe e nga tokat tjera të liruara, të cilët gjatë luftërave ballkanike, sidomos pas Kryengritjes së shtatorit të vitit 1913, e cila siç dihet, shpërtheu në Dibër, për shkak dhunës dhe terrorit të ushtrisë pushtuese serbe, qenë detyruar t'i lë-



shojnë vatrat e tyre për t'u vendosur në Tiranë, Elbasan etj., kërkonin riatdhesimin e tyre. Një dukuri e tillë shkaktoi probleme të shumta, sepse autoritetet ushtarake italiane insistonin që ata me çdo kusht të vendoseshin nëpër kampet e përqendrimit, e që kjo kundërshtohej nga komisar i lartë Fejzi Alizoti, i cili kërkonte të ktheheshin nëpër shtëpitë e tyre dhe të prisnin deri sa nuk gjendej ndonjë mundësi për strehimin e tyre përfundimtar.

Qeveria shqiptare, rëndësi të veçantë i kushtoi hapjes së shkollave shqipe, të cilat për herë të parë u hapën në këto troje gjatë vitit shkollor 1941/42. Për këtë qëllim, ministri i Arsimit, Ernest Koliqi, më 23 qershor 1941, përmes një shkrese njoftonte Këshillin e Ministrave me sa vijon: “Kam nderin të njoftoj se Ministria e Arsimit ka vendosë me dërgue s'afërmi në Kosovën e në Dibrën e çlirueme nga një Misjon të jashtëzakonshëm për të studjue në vend gjendjen arsimore nga çdo pikëpamje, si dhe ka një grup mësuesish për të hapë, me anën e këtyneve, kurse verore të gjuhës shqipe për të mëdhaj e të vegjël. Gjithashtu ka vendosë me dërgue një sasi të madhe librash, Flamujsh e kuadresh...”

Misionin shkollor për Prefekturën e Dibrës e përbënin: Prof. Fadil Repishti, kryetar, ndërsa anëtarë: Emin Çomo, Prof. Kel Gashi, Selim Alliu, Mexhit Bektashi dhe Pjetër Elezi. Detyra parësore të Misionit ishte: të kryej studimin e gjendjes faktike të arsimit fillor e të mesëm në ato vise, si p.sh., cilat ishin qendrat shkollore që kishin funksionuar gjatë vitit shkollor 1940/41; sa ishte numri i nxënësve dhe i mësuesve për secilën shkollë veç e veç; sa dhe cilat nga ato qendra shkollore ishin të pastra shqiptare, sa të përziera e sa të pastra sllave; në çfarë gjendje janë objektet shkollore; ku duhet, ose mund të hapen shkolla tjera; sa djem e vajza shqiptare e kanë kryer

ose e kanë ndjekë shkollimin e mesëm etj. Përveç kësaj, Misioni duhej që për një afat sa më të shkurtë të bëj organizimin e kurseve verore për mësimin e gjuhës shqipe si me të miturit ashtu edhe me të moshuarit. Për këtë qëllim, nga ana e Ministrisë së Arsimit, u lëshua një qarkore deri te inspektoritë e Arsimit të shtetit shqiptar, nga të cilat u kërkuar që në baza vullnetare të hartojnë lista të arsimtarëve, të cilët siç thuhet në të: “çfaqin dëshirën e tyre me u transferue në vendet e shli-rueme”.

Duke u mbështetur në raportet e inspektorateve, qartë shihet se një numër i madh i arsimtarëve, me kënaqësi e kishin pranuar të punojnë në viset e çlirueme, me ç'rast, po i referohemi raportit të Inspektorisë së Arsimit për qarkun e Durrësit, dërguar në fillim të muajit korrik 1941 deri te Ministria e Arsimit, ku thuhet: “Jemi të lumtur t'ia paraqesim Asaj PT. Ministrisë një listë të gjatë arsimtarësh vullnetarë, të cilët janë gati me derdhë gjithë energjitë e vlefshme të tyre për ringjalljen e vendeve të shliueme. Vullnetarët e këtij qarku arrijnë numrin 19; shumica e ktij numri njifet prej ksaj Inspektorije si element i zgjedhun dhe puntuer”.


Një jehonë e tillë ishte edhe në inspektorit tjera, me çka për një afat të shkurtë kohorë numri i mësuesve të cilët kishin shprehur dëshirën të punojnë në viset e çliruara arriti mbi 150. Nga ky numër, 37 u caktuan të dërgohen në Prefekturën e Dibrës së Madhe, edhe atë: Zihni Çiça - Tiranë, Jusuf Kaba - Tiranë, Mustafa Shahinaj - Trebishtë, Mit'hat Cami - Harabel (Dibër), Remzi Sefedini - Kërçishtë (Dibër), Gavril Banto - Podgorje (Korçë), Ismail Bedhija - Korçë, Spiro Popa - Elbasan, Hamid Muça - Tiranë, Qamil Blloshmi - Pogradec, Haki Pohuni - Allajbegi (Dibër), Dalip Zejnli - Bellovë (Dibër), Teufik Balla - Muhur (Dibër), Islam Hoxha - Sohodoll

(Dibër), Irfan Uruçi - Zerqan (Dibër), Shyqri Skenderi - Zerqan, Esat Mezelxhiu - Ostren i Madh (Dibër), Hidër Manjani - Kovashicë e Homeshit (Dibër), Edip Tërshana - Durrës, Qamil Skuqi - Elbasan, Murteza Peza - Kodovjat (Elbasan), Ahmet Gjylaçi - Elbasan, Hysein Çela - Durrës, Pjetër Kavaja - Ndroq (Durrës), Ibrahim Xhafa Kavajë, Jovan Popa - Herbert (Durrës), Abdyl Keçi - Shijak, Zejnel Zajmi - Krujë, Xhemal Kulli - Krujë, Kamber Kazazi - Krujë, Hasan Brahimi - Krujë, Muhamet Çerisha - Qerreke (Durrës), Hysen Kola - Burell, Nuri Sula - Peshkopi, Ymer Beqiri - Peshkopi dhe Mit'hat Hoxha - Durrës.

Të gjithë ata, në mënyrë të organizuar me 7 korrik, së bashku me anëtarët e Misionit Shkollor, nga Tirana arritën në Dibër të Madhe, të cilët u pritën në mënyrë madhështore nga popullsia shqiptare. Anëtar i Misionit Shkollor, Peter Elezi, në një shkrim botuar më 27 shtator 1941 në gazetën Kosova, ndër të tjerave shkruante:

“...Populli i maleve të Dibrës thotë: ‘GJUHA ASHT TAPIA E VENDIT’. Me datën gjashtë korrik të këtij viti u nisëm nga Tirana për në Dibër të Madhe, ku ishte caktue qendra e një Komisionit Shkollor të Jashtëzakonshëm. Me shtatë të muejit mbërritëm n'atë qytet, ku kishte me u mbledhë i tanë grupi arsimuer i përbamë prej 42 vetash: këta arsimtarë i kishte shënue PT. Ministria e Arsimit Kombëtar, për me u dhanë lajmin e LIRIS shqiptarvet të dridhun ndër zgjedhën e randë shekullore e për me u mësue fillimet e para të gjuhës amtare zogjve të shqipes. Të gjithë arsimtarët dukeshin sikur fluturojshin nga gëzimi, se ia mbërritën kësaj dite: dhe populli dibran, që e ka qamë me lot Lirin e vet, i priti me gaz. Ishte trazue gëzimi me habin; ishte një ngjarje si ajo e atij që gjeti të bin e humbun...”

(vijon në numrin e ardhshëm)



Filmi "Rreze" me regji të Lorena Sopit, fiton çmim në Los Angeles

Filmi është realizuar sipas "Ditarit të Luftës", të Rreze Abdullahut. Filmi "Rreze" me regji të Lorena Sopit mbrëmë ka fituar çmimin "Filmi më i mirë i luftës" në festivalin "Movie Screen Pro Film Festival", që u mbajt nga data 11 deri më 16 shtator në Los Angeles, SHBA. Ky është çmimi i parë për filmin "Rreze", që e pret një rrugëtim i gjatë ndërkombëtar. Filmi në muajin maj u shfaq premierë në Cannes Film Festival – Short Film Corner, si dhe në festivalin e famshëm San Gio Verona Film Festival. Filmi gjatë këtij muaji dhe muajit në vijim, do të shfaqet në programet zyrtare të Goa Short Film Festival – Goa, Indi, Asa Humanitarian Film Festival – Weimar, Gjermani, Corto e a Capo Film Festival – Venticano, Itali, Sose International Film Festival – Yerevan, Armeni, Roma Independent Film Festival – Roma, Itali, Festival Film International Signes de Nuit – Paris, Francë, etj. "Në ditëlindjen e nëntë, gjatë vitit të luftës 1999, Rreze Avdullahu kishte shkruar Ditarin e Frikës. Atë ditë të shenjuar, ajo nuk kishte pritur dhurata e as festë. Ajo kishte vetëm një dëshirë: Nuk donte të vdiste. Atë ditë, Rrezja shkoi te ushtari serb që bënte roje dhe i thotë: unë sot e kam ditëlindjen dhe nuk po due me vdekë! Veç po due me mbetë gjallë... Ushtari nis e qanë. Rrezja befasohet sepse kishte kujtuar që ushtarët nuk qajnë kurr. Tetëmbëdhjetë vjet më vonë, mbi gërmadhat e së kaluarës, Rrezja shfaqet e dëshpruar me botën që nuk është bërë më e mirë... Filmi 'Rreze' është realizuar sipas 'Ditarit të luftës' të Rreze Abdullahut", thuhet në njoftimin e regjisorës. Në rolet kryesoret të këtij filmi luajnë: Agron Shala, Gloriza Shala, Aurita Agushi. Në rolet tjera paraqiten: Selman Lokaj, Beslidhje Bytyqi dhe Uran Duli. Filmi është me regji të Lorena Sopit, kompozitor Mendi Mengjiqi, drejtor fotografie Besnik Hasolli dhe zëri Gëzim Rama.

TË KUJTOHET E MOS TË HARROHET

"Familjet katolike shqiptare në Shkup, (dokumente, fotografi, dëshmi I), studim dhe botimi Instituti i Trashëgmisë Shpirtërore e kulturore të shqiptarëve të Shkupit (2018), Acta non Verba. Autorë: Skender Asani, Albert Ramajm Natasha Didenko, Shkup, 2018, f. 481

Don Lush GJERGJI

Ky libër mbulon një zbrazëti dhe mangësi historike dhe aktuale për Shkupin e dikurshëm, sidomos sivjet në 90 vjetorin e nisjes së Shën Nënës Tereze për misionë në Indi.

"Memoria perditur", po trettet kujtesa, pasi që çka nuk është shënuar dhe dokumentuar, si të mos kishte egzistuar.

"I mençuri shkruan, i marri mbanë në mend", thotë fjala popullore, ose urtia latine: "Verba volant, scripta manent" – fjalët fluturojnë, shkrimet qëndrojnë. Mungesa e këtij qëndrim na ka dëmtuar shumë historikisht dhe aktualisht gati në çdo lëmi.

Prandaj, të kujtohet e mos të harrohet, qortim historik dhe gjithnjë aktual për ne.

Ky studim dhe botim është mjaft i qëlluar, i rrallë dhe specifik, deri diku i plotëson nevojat e historiografisë sonë kaq të mangët, të copëtuar dhe cinguar, të pranishme ende kryesisht nëpër arkive të huaja, aty-këtu edhe ndër ne.

Botimi në fjalë është dy gjuhësor, shqip dhe anglisht, për një ko-



munikim sa më të gjerë dhe domethënëse.

Pjesa e parë i kushtohet iple-shkvisë Shkup-Prizren nëpër shekuj, me trajtim të veçantë të disa figurave karizmatike, si Imzot Pjetër Bogdani, Toma Raspasani, Don Zef Ramja, Imzot Lazër Mjeda...

Një kapitulli i rëndësishëm i kushtohet shkollave katolike shqiptare në Shkup, si dhe kontributit të çmuar të Kolë Bojaxhiut në këtë drejtim.

Nuk lihet pasdore as figura e ndritur e Don Ndue Bytyqit, shkupjan, poet, shkrimtar, përthyes, mësues, bamirës, patriot, fatkeqësisht pak i njohur dhe studjuar ndër ne.

Në këtë monografi përpunohen edhe figura e prof. Lorenc Antonit, njeri shumë i lidhur me familjen Bojaxhiu, sidomos me Gonxhen, nga i cili kam marrë shumë shënime, dëshmi dhe fotografi. Dua të theksoj se jeta e tij artistike ka filluar me Gonxhe Bojaxhiu, me komponimet e parë të poezisë së Hil Mosit, Në breg të liqenit, enkas për Gonxhen dhe Dranen (25 mars 1928), dhe ka për-

funduar me komponimin e tekstit Lamtumirë, (shtator të vitit 1991), që është himni i bamirësisë. OKB-ja, siç dihet, 5 shtatorin e ka shpallur Dita Ndërkombëtare të Bamirësisë.

Nuk mungojnë as figurat tjera, si Dr. Don Gaspër Gjini, Vinçenc Gjini e tjerë.

Një kapitulli i veçantë i kushtohet Gonxhe Bojaxhiut - Nënës Tereze dhe Nasta Mihillit, m. Gabriela, si motra të Loretos.

Botimi vijon me familje tjera shqiptare katolike: Antoni, Serreqi, Ukajdini, Gjini, Nreca, Marku.

Pjesa e fundit i paraqet varrezat katolike shqiptare në Shkup, si dëshmi e gjendjes së vështirë edhe për të vdekur, e jo më për të gjallë, me trysni të ndryshme. Libri përfundon me historinë e kishave në Shkup.

Përparësitë e këtij botimi:

- Është studimi dhe libri i parë i tillë ndër ne;
- Shpjegon dhe dokumenton me fakte, dëshmi dhe fotografi kontekstin familjar, shoqëror, fetar dhe kulturor të asaj periudhe në Shkup;
- Argumenton trashëgimin hi-



storike shumëvjeçare, si mundësi për ta njohur Shkupin të atëherëshëm tonë dhe të Gonxhe Bojaxhiut, kontekstin shpirtëror, kulturor, fetar dhe kombëtar që e linden, rriten dhe edukuan Nënën tonë Tereze.

Ndoshta, me ndonjë studim dhe botim të ardhshëm, mund të përpunohet më tepër famullia e "Zemrës së Krishtit", verpimtaritë e ndryshme baritore, shkollore, edukative, fetare dhe kombëtare të meshtarëve që kanë ndikuar në edukim dhe formimin e Gonxhe Bojaxhiut në fëmijëri dhe rini, ndihma e tyre për zblulimin dhe zbatimin e thirrjes rregulltare dhe misionare.

Prishtinë, 26 gusht 2018

Këta janë 5 librat që do t'ju ndryshojnë jetën nëse i lexoni

Kur një nga biznesmenët më të sukseshëm në botë, Warren Buffett u pyet rreth sekretit të shëndetit të tij dhe suksesit ai u përgjigj se lexon çdo ditë 500 faqe për të qenë më të saktë. Fatkeqësisht, jo të gjithë kanë mundësi të lexojnë çdo ditë për më tepër kaq shumë, por ajo çka është më e rëndësishme janë librat që ne lexojmë. Janë 5 libra të cilët të ndryshojnë konceptin për jetën, siç shkruan revista "Blinkist".

1. Thirteen Things Mentally Strong People Don't Do by: Amy Morin
Askush nuk mund ti shpëtojë fatit të keq në jetë, por të gjithë mund të ndryshojmë mënyrën sesi i përgjigjemi. Autorja Morin ndan me ne terapitë më të suksesshme për të kaluar vështirësitë.



2. How to Stop Worrying and Start Living by: Dale Carnegie

A ju ka ndodhur ndonjëherë të pyesni veten se pse nuk mund të ndaloheni të shqetësoheni për diçka? Pavarësisht sa shumë përpiqeni, ju përsëri fiksoheni te ai problem. Duke kuptuar burimin stresit ju mund ta kapërceni një herë e mirë atë. Autoria Carnegie paraqet disa formula efikase për

të parandaluar mendimin e tepërt.

3. How will You Measure Your Life? By: Clayton M. Christensen, James Allworth and Karen Dillon
Çfarë mendon se do të të lumturorë në punë? Ndosht një rritje rroge, ose një lavdërim nga kolegët? A po ndiqni rrugën e duhur në jetë? Këto janë pyetje të cilat i kanë

përgjigjet në librin e lartpërmendur.

4. Finding Your Element by: Ken Robinson

Çdo njeri e ka një pasion. Dhe nëse ti nuk e di se cili është i joti do të thotë se nuk e keni gjetur akoma, ose ju ka humbur në rrjedhën e jetës. Zbulojë tani sesi thyhen rregullat e një shoqërie strikte dhe gjej zërin tënd në jetë.

5. Emotional Intelligence by: Daniel Goleman

A janë emocionet ato që na mbajnë të lidhur? A do të ishte më mirë sikur të ishim vetëm krijesa logjike pa emocione? Autorja Goleman na bën të kuptojmë si ti kontrollojmë emocionet tona dhe të marrim vendime më të sakta në jetë.




Guardiola jep OK, City përgatit rinovimin e Sterling

Manchester City përgatit bisedimet për rinovimin e kontratës me Raheem Sterling. Sulmuesit anglez i skadon kontrata në vitin 2020 dhe prej kohësh kishte kërkuar bisedime për zgjatjen e saj, por klubi nuk kishte reaguar çka riktheu zërat e merkatos rreth 23-vjeçarit. Tani është Guardiola që ka dhënë "OK" për të blinduar sulmuesin anglez i cili ka mirëpritur vendimin pasi dëshira e vetme e tij është të qëndrojë te Manchester City pavarësisht se klube të tjera të mëdha janë gati të bëjnë oferta të çmendura për shërbimet e lojtarit.

PSG dhe Tottenham synojnë yllin e Celta Vigos



Stanislav Lobotka mbetet në qendër të merkatos edhe pse zyrtarisht ajo është e mbyllur. Në verë lojtari sllovak pati oferta dhe kërkoj largimin nga Celta Vigo por klubi refuzoi çka solli edhe ftohje të raporteve mes palëve. Është Paris Saint Germain dhe Tottenham që janë gati të bëjnë një ofertë në merkaton e janarit për mesfushorin 23-vjeçar i cili shpreson që të konkretizojë largimin e për të bërë hapin e madh të karrierës.



Pogba shënoi dy golat e parë të ndeshjes, njëra prej të cilëve ishte nga pika e penaltisë, ndërsa tjetrën e shënoi bashkëkombësi i tij, Anthony Martial. Pas ndeshjes, Pogba tha se përkundër që ata mund të kishin luajtur edhe më mirë, ai është i kënaqur me ndeshjen

KEMI MENTALITET MË TË FORTË

Mesfushori francez i Manchester Unitedit, Paul Pogba, ka thënë se ata kanë mentalitet më të fortë pas tri fitore radhazi, dy në Premierligë, ndërsa e treta dje në Ligën e Kampionëve kundër Young Boys. Pasi i kishte humbur dy nga tri ndeshjet e para të Premierligës, Unitedi u rikthye fuqishëm, duke siguruar fitore kundër Burnley dhe Watfordit në Premierligë, transmeton Gazeta Express.

Përveç këtyre dy ndeshjeve të Premierligës, "Djajtë e kuq" e fituan edhe ndeshjen e parë të këtij sezoni të Ligës së Kampionëve, kundër Young Boys në Zvicër, me rezultat

3-0. Pogba shënoi dy golat e parë të ndeshjes, njëra prej të cilëve ishte nga pika e penaltisë, ndërsa tjetrën e shënoi bashkëkombësi i tij, Anthony Martial. Pas ndeshjes, Pogba tha se përkundër që ata mund të kishin luajtur edhe më mirë, ai është i kënaqur me ndeshjen.

"Natyrish, kur fiton je më i lumtur, tani kemi edhe mentalitet më të fortë sepse po përmirësohemi. E ndryshuam skuadrën, por tani edhe lojtarët e rinj janë bërë menjëherë pjesë e ekipit, dhe kjo gjë ishte shumë e nevojshme për ne", ka thënë Pogba. "Është një fito-

re shumë e rëndësishme sepse ishte ndeshja e parë e Ligës së Kampionëve, kishin nevojë të fillonim mirë, gjë të cilën e bëmë. E morëm rezultat që dëshëm. Ndoshta performanca mund të kishte qenë më e mirë, por ne e kemi këtë rezultat dhe tri pikët", është shprehur mesfushori francez i Manchester Unitedit. "Kështu që jam shumë i lumtur që kam shënuar dhe që isha vendimtar në këtë fitore për skuadrën time. Nëse e bëj këtë, të tentoj ta ndihmoj skuadrën sa më shumë, nëse mund të shënoj dhe asistoj, atëherë kjo gjë është e mrekullueshme".

VAR-i i nevojshëm në Ligën e Kampionëve

Trajneri i Juventusit, Massimiliano Allegri, beson se kartoni i kuq ndaj Cristiano Ronaldos në Ligën e Kampionëve, në debutimin ndaj Valencias, është dëshmi se aty duhet të përdoret teknologjia VAR. Pas fitores 2 me 0, Allegri ka thënë se rasti i Ronaldos do të ishte shumë i qartë për gjyqtarin sikur ai të kishte mundësinë e përdorimit të VAR-it. Ronaldo u ndëshkua me të kuq pas një sjellje jospportive. "Mund të them vetëm që VAR-i do të ndihmonte gjyqtarin në vendimin e tij. Të lua-



sh me 10 lojtarë në Ligën e Kampionëve për një incident si ai, është zhgënjyese. Rrezikuar të

humbim, dhe do të na mungojë për ndeshjet e ardhshme po ashtu", ka deklaruar Allegri.



Distria Krasniqi humb në Botëror

Xhudistja kosovare Distria Krasniqi ka pësuar humbje nga ukrainasa Daria Bilodidin në rrethin e dytë të të Botërorit që po mbahet në Baku. Kosovarja u mposht 1 me 0 në kuadër të kategorisë deri në 48 kilogramë.

Inter-Icardi, kontrata e re ende në "ajër"



Për çdo ndeshje që kalon, duket akoma më i qartë fakti se Mauro Icardi është pika kyçe e skuadrës së Interit. Por, mund të thuhet se ka edhe probleme. Bëhet fjalë për rinovimin e kontratës së argjentinasit, e cila skadon në vitin 2021. Pavarësisht se të dyja palët duken të qeta në lidhje me këtë situatë, ato janë akoma larg marrëveshjes, duke marrë parasysh kërkesat e larta të sulmuesit për rrogën. Në merkaton e verës që lamë pas, Icardi ka marrë tre oferta të majme, nga klube të nivelit të lartë, shifra shumë më të larta se 4.5 milionët që merr në sezon tek Interi, numër i cili u rrit edhe prej kualifikimit në Champions League. Pozicioni i tij është mjaft i qartë. Ndihet shumë mirë tek Interi, e nuk ka ndërmend të krijojë probleme, por 25 vjeçari pret nga Suning një propozim si ato që i erdhën në verë. Edhe vetë klubi zikaltër dëshiron qëndrimin e lojtarit, por nuk e ka hedhur ende hapin e parë për zhbllokimin e situatës. Është e qartë se kontrata nuk skadon shpejt, por gjithashtu jo shumë vonë, dhe klubet e interesuara qëndrojnë gati për çdo rast që mund t'i paraqitet. Nga kapiteni sinjali është i qartë. Ai që duhet të lëvizë shpejt është Interi.

Lajm i mirë për kuqezinjtë dhe verdhekaltrit


Pas humbjes ndaj Skocisë, Shqipëria e Christian Panuccit merr një lajm të mirë nga FIFA. Institucioni më i lartë i futbollit Botëror ka publikuar renditjen e re për muajin shtator me kuqezinjtë që kanë ngjitur një shkallë në klasifikim. Fitorja 1-0 ndaj Izraelit në Elbasan Arena ka qenë një bonus i madh për Shqipërinë aq sa humbja ndaj Skocisë nuk ka ndikuar dhe aq. Kuqezinjtë aktualisht janë të 57-ët në botë me 1383 pikë. Shqipëria lë pas përfaqësuesetë tilla si Ekuadori, Finlanda, Bolivia e Sllovenia, ndërsa para kombëtares shqiptare pozicionohen Japonia, Koreja e Jugut dhe Burkina Faso. Nga vendi i 58-të ta-



shmë jemi të 57-ët, shumë larg rekordit historik të 2015-ës kur Shqipëria e De Biasit në gusht të atij vitit ishte e 22-ta në renditjen Botë-

rore. Sidoqoftë, ekipi i Bernard Challandes tash gjendet në pozitën e 138-të me 1092 pikë, kurse në renditjen e muajit të kaluar ish-

te i 141-ti. E 138-ta në botë, Kosova që pas barazimit ndaj Azerbajxhanit dhe fitores ndaj Ishujve Faro në Ligën e Kombeve, ka ngjitur tre pozicione. Verdhekaltrit kanë përparuar për tri pozita në renditjen e publikuar nga shtëpia e futbollit botëror. Në këtë përparim kanë ndikuar rezultatet e fundit të ekipit përfaqësues kosovar, respektivisht barazimi në udhëtim ndaj Azerbajxhanit dhe fitorja ndaj Ishujve Faro në Ligën e Kombeve. Kosova pritej të kishte ngritje më të madhe. Vendi i parë çuditërisht ndahet nga Belgjika dhe Franca në kuotë të barabartë pikësh për këtë muaj ndërsa ndiqen nga Brazili, Kroacia, Uruguai dhe Anglia.



Republika e Maqedonisë
Komuna e Sopištes

Tel:++389 2 27 85 100
Faks: ++389 2 27 85 109
Rr. 2, Nr 2, f. Sopištes, 1054
Shkup, Republika e Maqedonisë
www.opstinasopiste.gov.mk


Nr. i procedurës: 16617
Nr. 28-60/18 nga 20.09.2018

LAJMËRIM

Për organizim të Anketës dhe prezantimit publik për **Projektin arkitektonik-urbanistik për objektin me qëllim A1-banim në shtëpi banesore për PK 1075/1, PK 1075/6, PK 1075/7, PK 1075/15, PK 1076/7 dhe PK 1077/7, KK Dollno Sonje-ndr, Komuna e Sopištes.**
Bëhet zbatim i prezantimit dhe anketës publike për **Projektin arkitektonik-urbanistik për objektin me qëllim A1-banim në shtëpi banesore për PK 1075/1, PK 1075/6, PK 1075/7, PK 1075/15, PK 1076/7 dhe PK 1077/7, KK Dollno Sonje-ndr, Komuna e Sopištes.**
Përfshirja planore dokument për **Projektin arkitektonik-urbanistik për objektin me qëllim A1-banim në shtëpi banesore për PK 1075/1, PK 1075/6, PK 1075/7, PK 1075/15, PK 1076/7 dhe PK 1077/7, KK Dollno Sonje-ndr, Komuna e Sopištes** është me sipërfaqe prej 983 m2.

1. Prezantimi dhe anketa publike do të realizohet me prezantimin e planit në lokalet e Komunës së Sopištes më datë **24.09.2018 në ora 11.00.**
2. Anketa publike do të zgjasë deri më **28.09.2018**, në bazë të nenit 51 paragrafi 10 të Ligjit për Planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16, 33/17 dhe 168/18).
3. Informohen të gjithë qytetarët dhe subjektet e interesuara juridike nga rajoni konkret të përfshirë me planin në afatin e lartpërmendur të dorëzojnë vërejtje, propozime, mendime në listat anketuese në administratën komunale.
4. Informata në tel. 2 785 102

Kryetari i Komunës së Sopištes
Stefçe Trpkovski



Republika e Maqedonisë
Komuna e Sopištes

Tel:++389 2 27 85 100
Faks: ++389 2 27 85 109
Rr. 2, Nr 2, f. Sopištes, 1054
Shkup, Republika e Maqedonisë
www.opstinasopiste.gov.mk


Nr. i procedurës: 16614
Nr. 28-62/18 nga 20.09.2018

LAJMËRIM

Për organizim të Anketës dhe prezantimit publik për **Projektin arkitektonik-urbanistik për objektin me qëllim A1-banim në shtëpi banesore për PK 1109/1, KK Dollno Sonje-ndr, Komuna e Sopištes.**
Bëhet zbatim i prezantimit dhe anketës publike për **Projektin arkitektonik-urbanistik për objektin me qëllim A1-banim në shtëpi banesore për PK 1109/1, KK Dollno Sonje-ndr, Komuna e Sopištes.**
Përfshirja planore dokument për **Projektin arkitektonik-urbanistik për objektin me qëllim A1-banim në shtëpi banesore për PK 1109/1, KK Dollno Sonje-ndr, Komuna e Sopištes** është me sipërfaqe prej 982 m2.

1. Prezantimi dhe anketa publike do të realizohet me prezantimin e planit në lokalet e Komunës së Sopištes më datë **24.09.2018 në ora 11.00.**
2. Anketa publike do të zgjasë deri më **28.09.2018**, në bazë të nenit 51 paragrafi 10 të Ligjit për Planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16, 33/17 dhe 168/18).
3. Informohen të gjithë qytetarët dhe subjektet e interesuara juridike nga rajoni konkret të përfshirë me planin në afatin e lartpërmendur të dorëzojnë vërejtje, propozime, mendime në listat anketuese në administratën komunale.
4. Informata në tel. 2 785 102

Kryetari i Komunës së Sopištes
Stefçe Trpkovski



Republika e Maqedonisë
Komuna e Sopištes

Tel:++389 2 27 85 100
Faks: ++389 2 27 85 109
Rr. 2, Nr 2, f. Sopištes, 1054
Shkup, Republika e Maqedonisë
www.opstinasopiste.gov.mk

Nr. i procedurës: 16615
Nr. 28-61/18 nga 20.09.2018

LAJMËRIM

Për organizim të Anketës dhe prezantimit publik për **Projektin arkitektonik-urbanistik për objektin me qëllim A1-banim në shtëpi banesore për PK 1109/4, PK 1075/2 dhe PK 1075/3, KK Dollno Sonje-ndr, Komuna e Sopištes.**
Bëhet zbatim i prezantimit dhe anketës publike për **Projektin arkitektonik-urbanistik për objektin me qëllim A1-banim në shtëpi banesore për PK 1109/4, PK 1075/2 dhe PK 1075/3, KK Dollno Sonje-ndr, Komuna e Sopištes.**
Përfshirja planore dokument për **Projektin arkitektonik-urbanistik për objektin me qëllim A1-banim në shtëpi banesore për PK 1109/4, PK 1075/2 dhe PK 1075/3, KK Dollno Sonje-ndr, Komuna e Sopištes** është me sipërfaqe prej 1423 m2.

1. Prezantimi dhe anketa publike do të realizohet me prezantimin e planit në lokalet e Komunës së Sopištes më datë **24.09.2018 në ora 11.00.**
2. Anketa publike do të zgjasë deri më **28.09.2018**, në bazë të nenit 51 paragrafi 10 të Ligjit për Planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16, 33/17 dhe 168/18).
3. Informohen të gjithë qytetarët dhe subjektet e interesuara juridike nga rajoni konkret të përfshirë me planin në afatin e lartpërmendur të dorëzojnë vërejtje, propozime, mendime në listat anketuese në administratën komunale.
4. Informata në tel. 2 785 102

Kryetari i Komunës së Sopištes
Stefçe Trpkovski

Në bazë të nenit 176 paragrafi 1 të Ligjit për arsim të lartë (Gazeta Zyrtare e RM nr. 82/2018) dhe nenit 34 paragrafi 2 i Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje të titujve mësimor shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë dhe doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup (Fletorja universitare nr. 138/2009, 173/2011, 194/2011, 250/2013 dhe 274/13), drejtori i Institutit bujqësor në Shkup, publikon

KONKURS

Për zgjedhjen e: një mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor gjegjësisht shkencor, nga fusha shkencore shkencat bioteknike, sfera prodhimitaria bimore, në sferën shkencore: **gjenetika dhe selektimi i prodhimeve bujqësore (shifra 40308).**

Kushtet: Krahas kushteve të përgjithshme, kandidatët duhet t'i plotësojnë edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim të lartë, Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje të titujve mësimor shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë dhe doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup dhe akteve të tjera të Universitetit dhe Institutit.

Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët duhet të dorëzojnë: biografi, deklaratë për përbushje të kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës dhe certifikatë të shtetësisë.

Zgjedhja e kandidatëve bëhet në përputhje me Ligjin për arsim të lartë dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje të titujve mësimor shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë dhe doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup.

Shuma e pagesës dhe orari i punës është përcaktuar në aktet e Institutit, ndërsa marrëdhënia e punës është për kohë të pacaktuar.

Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve është 8 ditë nga dita e publikimit të Konkursit. Dokumentet dorëzohen në Institutin bujqësor në Shkup, rr. 16-ta Makedonska Brigada 3A, 1000 Shkup.

**Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup
Instituti bujqësor në Shkup**



Alb Kultura

Shpallet konkurs për pjesëmarrje në festivalin e muzikës zbavitëse shqipe "Boom Fest" 2018, edicioni i parë.
Pjesëmarrësit e interesuar duhet të kenë këngën në WAV format, master ose demo incizim.
Për informata më të hollësishme, na shkruani në e-mail adresën.
boomfestivali@hotmail.com
ose në
tel. +38970622059.

Konkursi është i hapur deri me 01.10.2018.

Në bazë të nenit 156, 157, 158, 159, 160 dhe 161 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 43/2012, 145/2012, 87/2013, 164/2013, 39/2014, 43/2014, 132/2014, 188/2014, 10/2015, 61/2015, 154/2015, 192/2015, 17/2016 dhe 37/2016), nenit 22 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 74/15...120/18), nenit 7 paragrafi 1 të Marrëveshjes kolektive për veprimtari shëndetësore në Republikën e Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 60/06...137/16) pëlqimit për punësim të Ministrisë së financave nr. 18-2784/2 të datës 08.03.2018, Pëlqimit të Ministrisë së shëndetësisë nr. 22-1334/2 të datës 23.02.2018 dhe Vendimit për publikim të shpalljes publike nr. 04-1987/1 të datës 20.09.2018, UD Drejtori i IPSH Qendra për shëndet publik – Strumicë publikon

SHPALLJE PUBLIKE
Për punësim të punëtorit shëndetësor për kohë të pacaktuar

1. **IPSH Qendra për shëndet publik – Strumicë ka nevojë për punësim të:**
- **Doktor të medicinës për kohë të pacaktuar - 1 (një) realizues**
2. Kandidatët duhet t'i plotësojnë **kushtet e përgjithshme** të vërtetuara me Ligjin për mbrojtje shëndetësore
- të jetë shtetas i RM,
- të jetë i moshës së rritur,
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore, dhe
- të mos jetë të shqiptuar me vendim të plotfuqishëm ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës
3. Përveç kushteve të përgjithshme të vërtetuara me ligj kandidatët duhet t'i plotësojnë edhe kushtet e **posaçme në vijim:**
- Arsimit sipëror të mbaruar me së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të Fakultetit të medicinës
- provim të dhënë profesional
- licencë për punë
--me ose pa përvojë pune.
4. Orari javor i punës është 40 orë. Neto pagesa fillestare për Doktor të medicinës do të paguhet sipas Marrëveshjes kolektive për veprimtari shëndetësore në Republikën e Maqedonisë që është 26.171,00 denarë.
5. Me fletëparaqitjen kandidatët janë të obliguar t'i dorëzojnë dokumentet në vijim
- Fletëparaqitje me të dhëna për kontakt
- Biografi të shkurtër (CV)
- Diplomë me sukses mesatar
- dëshmi për njohje të gjuhës së huaj (angleze, frënge ose gjermane).
- Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- certifikatë të mjekut jo më të vjetër se 6 muaj, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- Certifikatë se nuk është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- Certifikatë për fakultet të mbaruar të medicinës, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- Certifikatë për provim të dhënë profesional, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- Licencë për punë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter.
6. Afati për paraqitje në shpalljen publike është **5 (pesë) ditë pune** nga dita e publikimit.
7. Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, i pakompletuar dhe i parregulluar nuk do të merret parasysh nga ana e komisionit për selektim të kandidatëve.
8. Pas selektimit të realizuar të kandidatëve të paraqitur për doktor të medicinës të cilët i plotësojnë kushtet nga shpallja publike, do të realizohet provim kualifikues në pajtim me nenin 160 nga Ligji për mbrojtje shëndetësore.
9. Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e tërësishëm të nevojshëm dhe telefoni për kontakt të dorëzohen deri në IPSH Institutin për shëndet publik – Strumicë, ndërsa në shenjë për Shpallje publike për punësim.

IPSH Institutin për shëndet publik – Strumicë
UD Drejtor
M-r Petre Vitanov

KONKURS

Gazeta KOHA shpallë konkurs për:

- **përkthyes**

Kushtet: Kandidatët duhet të njohin mirë gjuhën:

- shqipe
- maqedone
- angleze

Të interesuarit duhet që CV-të e tyre t'i dërgojnë në e-mail adresën:
marketing@koha.com.mk.

Afati i dorëzimit të dokumenteve zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në gazetë.



Tel: 02 3179 - 904, Fax: 3118 - 060
marketing@koha.com.mk

Urgjentisht shitet shtëpi në rr. Pere Toshev nr. 30 - Xhon Kenedi, Shkup me sipërfaqe prej 140 m2 oborr dhe 116m2 objekt banimi. Kontakt telefoni 072/643 093

DEPAY IA PA HAIRIN LARGIMIT NGA MAN UNITED

Memphis Depay thotë se largimi i tij nga Manchester Unitedi e ka bërë atë një lojtar më të mirë. Reprerentuesi holandez, i cili kishte qenë pjesë e "Djajve të Kuq" për një vit e gjysmë, nuk kaloi një periudhë edhe aq të këndshme në "Old Trafford". Por ai ka shpërthyer pas transferimit të Lyonit në janarin e vitit 2017, duke realizuar 28 gola dhe 27 asistime

Sulmuesi i Lyonit, Memphis Depay, beson se ai është bërë një lojtar shumë më i mirë pas largimit nga Manchester Unitedi, shkruan sot gazeta Zëri. Depay, i cili ishte transferuar në "Old Trafford"



nga Louis van Gaal në vitin 2015, nga PSV Eindhoven për 27.9 milionë funte, kaloi 19 muaj të vështira të gjigandi anglez, duke regjistruar shtatë gola dhe gjashtë asistime në 53 paraqitje.

Ardhja e Jose Mourinhos në krye të stolit të "Djajve të Kuq" bëri që Depay të ketë edhe më pak minuta me 24-vjeçarin, që ishte paraqitur vetëm katër herë në Premierligë para se të largohej

në janar në drejtim të Lyonit për 21.7 milionë funte. Që prej transferimit të Lyonit Depay është kthyer në një lojtar titullar dhe ka shënuar 28 herë në 74 paraqitje. "Të gjithë e dinë që historia ime dhe e Manchester Unitedit nuk ishte e suksesshme dhe unë jam mjaft i lumtur kështu si jam sot", deklaroi reprerentuesi holandez.

"Mund të shikoj prapa dhe të them që nuk doja të shkonte ash-

tu, askush nuk e dëshoi atë, por gjërat ndodhën dhe unë jam bërë një lojtar edhe më i mirë tani. E ndiej në ndeshje, dua të them të gjithë mund ta shohin këtë gjë gjithashtu. Pas një sezoni nuk mund ta gjeja veten në skuadër. Unë isha ende i ri, nuk kisha shumë mundësi, por duhet të them që në sezonin e parë nuk e shfaqta kualitetin që mendoja", shprehet ai. Golashënuesi më i mirë

në historinë e Manchester Unitedit, Wayne Rooney, gjatë një interviste në javën e kaluar zbuloi se Depay nuk i ndiqte këshillat e tij derisa kishte shkuar njëherë për të luajtur me ekipin rezervë me makinën e tij të tipit "Rolls Royce", duke mbajtur një kapele të kaubojit dhe një xhakëtë të kuqe të lëkurës pas një paraqitjeje të dobët ndaj Stoke Cityt.

Depay i pranoi komentet e Rooneyt, por thotë se mbeti në mëdyshje në njërin prej fjalive të Rooneyt. "Disa njerëz nuk mund t'i kuptojnë shakatë dhe unë dhe Wayne jemi shokë shumë të mirë. Unë e kuptoj se çfarë dëshoi të thotë ai me këtë gjë dhe kaq. Kur e dëgjova unë thjesht po e pyesja veten, 'unë nuk kam xhakëtë të kuqe të lëkurës', nga qindra xhaketat unë nuk kam xhakëtë të kuqe të lëkurës.

"Kjo i përket së kaluarës dhe unë jam një njeri që i pëlqen ta ketë vëmendjen dhe që më pëlqejnë gjërat e mira, por kjo nuk do të thotë që s'mund të isha më i mençur. Jam pjekur më shumë. Ju kaloni përvoja të ndryshme në jetë dhe jashtë fushës", përfundoi Depay.

Publicitet

FONDE EVROPIANE PËR MAQEDONINË EVROPIANE



Ndihma totale vjetore e BE-së për Maqedoninë është 90 milion euro, respektivisht 260.000 euro në ditë.

Hyjmë në Union prej 500 milion konsumatorëve ose treg 250 herë më të madh se tregu vendor.

15.5 milion euro vjetore për Maqedoninë nëpërmjet Programës së BE-së për transport (fonde me të cilat ndërtohen rrugë, ura, hekurudha, tunele dhe infrastrukturë tjetër).

8.5 milion euro mjete evropiane për mbrojtjen e kufijve të Maqedonisë për vitin 2018.

15 milion euro mjete evropiane për bujqit në Maqedoni për vitin 2019.

18 milion euro në vitin 2020 për reformat në gjyqësor dhe policinë e Maqedonisë.

Me 30 shtator!

DIL PËR MAQEDONI EVROPIANE!



DASHI 21. mars - 20. prill

Duhet të nisni të zgjeroni horizontet tuaja dhe të zbuloni ndonjë mundësi të re e cila do ju lejojë që të përfshiheni maksimalisht në punë. Do të jeni gjithë vullnet dhe karizmatik, ndaj mos u druani të riktheheni në lojë. Këshillohet që të bëni kujdes ndaj ndonjë keqkuptimi të vogël në dashuri.



DEMI 21. prill - 21. maj

Parashikohet një ditë e cila ju sheh dembelë dhe të rënë moralisht, ndoshta për shkak të mungesës së stimulit të duhur për të marrë në dorë situatën dhe projektet e braktisura prej kohësh. Nga pikëpamja ekonomike parashikohen çështje mjaft të frytshme.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Kjo e enjte është mjaft e rëndësishme për të vënë në provë ndjenjat tuaja, sidomos nëse prej pak kohësh jeni përfshirë në një lidhje. Mos lejoni që të përfshiheni nga ankthi, i cili ju ka acaruar me partnerin/en. Në vendin e punës parashikohen suksese të mëdha.



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Është një mundësi shumë e mirë për të treguar krijimtarinë tuaj, sidomos nëse në vendin e punës jeni në kërkim të burimeve të reja të frymëzimit apo jeni në prag të nisjes së një rrugëtimi shumë premtues. Këshillohet që në mbrëmje të tregoni më shumë kujdes ndaj vetes.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Në këtë moment mund të stimulohet një bashkëpunim mjaft i frytshëm i cili do ju lejojë që të arrini një objektiv mjaft të rëndësishëm për karrierën tuaj profesionale. Mundohuni që në familje të jeni më të pranishëm.



VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Parashikohet një ditë e cila ju fton që të mos përhumbeni në zgjedhjet e bëra në të kaluarën, por të përqendrohni në vendimet që duhet të merrni tani, sidomos sa i takon stilit të jetës. Këshillohet që të mos jeni shumë të nxituar dhe drastik.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Do të jeni mjaft të angazhuar në zgjidhjen e konflikteve apo vonesave profesionale, të cilat gjithsesi do arrihen që ti përballoni me guxim. Mundohuni që të jeni sa më shumë krijues, edhe në dashuri, në mënyrë që të zgjoni bashkëpunimin në çift.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Këshillohet që ti kushtoni më shumë vëmendje ndjenjave tuaja, sidomos nëse së fundmi keni pësuar një zhgënjim të madh. Nga pikëpamja profesionale, parashikohen përgjigje dhe konfirmime të rëndësishme.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Duhet të ripërkufizoni, shumë nga projektet tuaja dhe kjo ndoshta për shkak të një të papriture apo një ndryshim ideje, gjë që do ju marrë kohë. Në dashuri duhet të mundoheni të jeni më të sqartë me veten tuaj dhe partnerin/en. Do ju duhet të kuptoni se çfarë kërkoni nga një lidhje, ndaj është mirë që të diskutoni.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Kohëve të fundit jeni përfshirë nga shumë paranoja, sidomos në dashuri. Këshillohet që të mos jeni shumë xheloz në raport me partnerin/en, në mënyrë që të mos ushqeni acarime të tjera. Duhet të jeni më të përqendruar në çështje që kanë të bëjnë me punën dhe investimet.



UJORI 21. janar - 19. shkurt

Kjo ditë do të jetë mjaft interesante për gjithë ata që kanë dëshirë të arrijnë objektivin e tyre. Përqendrohuni maksimalisht në qëllimin tuaj dhe mundohuni të jeni të vendosur për të marrë të gjithë suksesin e merituar. Horoskopi i kësaj të enjteje, ju fton që të mos lodheni shumë nga pikëpamja fizike.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Sharmi juaj do të jetë maksimal, ndaj nuk përgjash-tohen zhvillime të mëdha pozitive në sferën e ndjenjave. Këshillohet që të jeni më të kujdesshëm dhe të mos druheni të shpreheni, sidomos nëse jeni në një lidhje që zgjat prej kohësh.

Mensur Mamuti	USHTARAK UDHEHEQËS	BOTA, NJERËZIA	SHIH FOTON, FESTË E 21 SHTATORIT (NGA UNESCO)	KOMPANI AMERIKANE E VIDEO LOJËRAVE ABETARJA E VEQILHARXHIT	A
NXËNËS I SHKOLLËS SË MESME USHTARAKE					
ULLIRI					
NJËSI PËR MATIËN E GJATËSISË					
FAMILJA E NJOHUR ITALIANË E NDËRTIMIT TË VIOLINAVE					
KËNGËTARJA AMERIKANE, SIMONE					(NDESHJE) ELIMINUESE
GJERMANIA		KAFSHË ME BRIRË TË DEGEZUAR GAZ NDRIÇUES			
FAQE ANËSORE E NJË TRUPI				LITRI KOMUNË NË RUMANI	
FUA QË LIDH TRURIN ME ORGANET					
I JAP DORËN DIKUJT, PËRSHËNDETEM ME DIKË					VËNDON MINA
KOHA	SPORT I UJIT PERIUDHAT KOHORE NË NJË PUNË				FLET ME ZË, ME QËLLIM QË DËGJUESI TA SHKRUAJË PJESË E TRUPIT MUNGESA E NJOHURIVE PËR DIÇKA
ENERGJIA		PJESË E GJURIT VARG KURANOR			D
LOJË ME LETRA PIKA MË E LARTË E NJË MALI					PËREMËR VETOR RRIP LLASTIKU PËR TË MBAJTUR PANTALLONAT
M			ISH POLITIKANI BULLGAR, ZHIVKOV (SHQ.) AKTORJA JAPONEZE, MIJAZAVA		
AUTORI YNË, LUARASI					AJNSHTAJNIUMI
YLLI MË I NDRITSHËM I YJESISË SË SHQIPONJËS				JODI FOSFORI	TETOVA Q
TEMPERATURA		KOHA			



ZGJIDHJET: A, KADET, OLIVA, METËR, AMATI, NINA, D, DRE, ANË, L, NERVI, TOKEM, D, NOTIM, IJA, E, MENISKUS, TABLANET, K, MAJË, TODORI, PETRO NINI, ATAIR, J, TE, T, RE E PAQËS.

Shumë i lehtë **Sudoku** **mesatar**

8		7			6		1	2		3		5					
			6							5		1					
5	7		8			2	9		5				4	3			
					6	4	1		8		4			9			
	5		2		3		9	4						8			
6		8	1						9			2		6			
9	3				7		1	8	5	7							
				3						3		1		9	8		6
					9		5				9		2				4

Shumë i lehtë: 382795164, 149362875, 576841329, 723956481, 451283796, 698174532, 934527618, 215638947, 867419253. Mesatar: 126734589, 843591672, 957268143, 385416297, 462957318, 791382465, 578643921, 234179856, 619825734.

BUKA SHKAKTON DEPRESION DHE LODHJE!

Gluteni mund të shkaktojë depresion dhe lodhje te njerëzit më shumë se sa probleme të stomakut, sipas një studimi. Shkencëtarët kanë dalë në përfundimin se gluteni prodhon "reagime të shëndetit mendor" te njerëzit, pasi ata konsumojnë bukë ose makarona. Megjithatë disa njerëz janë vërtet intolerantë ndaj proteinës së grurit për shkak të një gjendjeje të quajtur sëmundja celiake, nga e cila vuajnë vetëm 1 për qind të njerëzve.

Por shumë më tepër, përafërsisht 12 për qind e njerëzve, pohojnë se janë të ndjeshëm ndaj glutenit që shkakton fryrje dhe dhimbje. Për të përcaktuar nëse kjo ndjeshmëri është e vërtetë ose është vetëm fantazi, studiuesit kryen teste "me sy mbyllur" mbi njerëzit dhe panë



simptomat e tyre. Nëpërmjet këtij procesi, studiuesit zbuluan se disa njerëz përjetojnë probleme reale të shëndetit mendor, si rezultat i konsumimit të ushqimit me shumë gluten. Studimi i kryer nga shkencëtarët në Universitetin La Trobe në Melburn, Australi, testoi se çfarë ndodhi kur 14 persona konsumuan gluten. Ata zbuluan se kur njerëzit merrnin

gluten kishin më shumë gjasa të ndiheshin të lodhur ose të përjetonin emocione negative, duke sugjeruar se gluteni ka efekte reale në tru. Udhëheqësja e studimit Jessica Biesiekierski tha: "Ne nuk po them se të gjithë do të kenë depresion pasi të hanë bukë ose makarona". Ajo shtoi se ky fenomen ka gjasa të ndodhë vetëm te një grup i vogël personash.

Mushmolla dhe të gjitha arsyet pse duhet konsumuar

Mushmolla është një nga frutat që rritet në të gjitha zonat e Shqipërisë, por më tepër kultivohet në Jug. Është pjesë e familjes së mollëve dhe dardhave, por shpesh e quajnë vogëlushja e trëndafilave, pasi janë të ngjashëm me frutat e trëndafilave të egër. Ky frut është i pasur me vitaminë C, kalium, kalcium, magnez, proteina, hekur dhe shumë elementë të tjerë ushqyes. Përveç shijes unike, mushmolla mbahet dhe si një frut që ndihmon në tretje, luftimin e infeksioneve dhe baktereve, bajamet e infektuara dhe organet e frymëmarrjes. Bëni kompost me disa lugë mushmolla të freskëta të grira, të lëna në një orë në ujë të vluar. Pini çdo ditë nga dy gota dhe shihni rezultatet.



T'u flasësh fëmijëve i bën më inteligjentë

Tu flasësh fëmijëve të vegjël ndikon në rritjen e kapacitetit të inteligjencës. Studimet e fundit në neuroshkencë dolën në konkluzionin se komunikimi me të vegjëlit ka efekte të përvojave të hershme në tru, veçanërisht për komponentin gjuhësor, njohës dhe socio-emocional. Në studimin e ri, pediatri treguan se përvoja gjuhësore në vitin e dytë të jetës ndihmon në aritjen e rezultateve të rëndësishme gjuhësore në fëmijërinë e vonë, me rezultate më të mira në aspektin e IQ të moshës shkollore.

Ekipi i studiuesve ka studiuar 146 fëmijë nga 2 deri në 36 muaj, duke shënuar numrin e përgjithshëm të fjalëve që ata i

kishin dëgjuar nga të rriturit çdo ditë dhe bisedat e tyre një herë në muaj, për një total prej 6 muajsh. Studiuesit më pas kryen teste njohëse kur të njëjtët fëmijë ishin midis 9 dhe 14 vjeç. Ekspozimi gjuhësor u vlerësua për 3 grupe moshe: 2 deri 17 muaj, 18 deri në 24 muaj dhe mbi 25 muaj.

Ata zbuluan se fëmijët me të cilët të rriturit kishin folur më shumë në 18-24 muaj kishin mesatarisht 14-27% performancë më të lartë në testet e IQ, kuptimin verbal dhe fjalorin receptiv dhe shprehëse. Përtej rezultateve akademike, le të mos lodhemi kurrë të flasim me fëmijët tanë, t'u tregojmë një histori, të jemi në gjendje të kalojmë kohë me ta, të cilësisë.

I burgosuri që la 4 gardiane shtatzënë

Katër gardiane të një burgu në Baltimore të Shteteve të Bashkuara ngelën shtatzënë me të njëjtin të burgosur. Rojet femra ishin mbuluar nga dhurata prej të burgosurit Tavo White, përfshirë këtu makina luksoze dhe unaza diamanti. Të ardhurat ai i siguronte nëpërmjet futjes në mënyrë të fshehtë të lëndëve narkotike dhe telefonave në burg, me ndihmën e të dashurave të tij. Nga ky aktivitet ai siguronte deri në 16 mijë dollarë në muaj. Cjatë hetimit të agjentëve federalë, White është regjistruar fshehurazi duke deklaruar "ky

është burgu im. Kuptojeni këtë". 4 rojet, Jennifer Owens, Katera Stevenson, Chania Brooks dhe Tiffany Linder kanë mbetur shtatzënë edhe pse White ndodhej pas hekurave. Madje Owens kishte tatuazh emrin e keqbërësit në qafë, ndërsa Stevenson në kyçin e dorës. E gjithë çështje u zbardh pas një hetimi të autoriteteve që ishin vënë në dijeni të një rrjeti që fuste drogë dhe sende të tjera që nuk lejoheshin në brenda në burg. 12 gardiane, 7 të përfshira drejtpërdrejt në këtë rrjet dhe 5 për moskallëzim të veprës do të hetohen.



1621 - Mbreti Xhejms i Anglisë i jep Kanadanë Sir Aleksandër Sterlingut
1776 - Zjarri i madh kaplon Nju Jorkun.

1913 - Turqia dhe Bullgaria nënshkruajnë traktat të paqes në Konstantinopolje

1949 - Udhëheqësit e komunistëve kinez shpallin Republikën Popullore të Kinës.

1953 - Forcat e Aleances formojnë Gjermaninë Perëndimore.

1957 - Olav V, bëhet mbret i Norvegjisë.

1964 - Malta fiton pavarësinë nga Britania.

1991 - Armenia votojnë nëse dëshirojnë ose jo të qëndrojnë nën Bashkimin Sovjetik.

2004 - Fillon ndërtimi i ndërtesës Burj Dubai.

KALENDARI 21 SHTATOR



KAFE TURKE DHE QUMËSHT, MASKA FRESKUESE E FYTYRËS!

Rigjenerimi ka rol shumë të rëndësishëm në parandalimin e plakjes së lëkurës.

Për të gjithë ata që preferojnë produktet shtëpiake, maska me kafe dhe qumësht është ideale për çdo lloj të lëkurës.

Gjithçka që na nevojitet janë, kafa turke dhe qumështi - këta dy përbërës i përzieni deri sa të formohet një krem i lëngshëm.

Maskën e vendosur në fytyrë rekomandohet ta lini për 15 minuta, më pas duhet ta pastroni me ujë të vakët.

A E DINI SE...

GRUAJA E INATOSUR

Vjen gruaja e nervozuar në shtëpi.

- Zemër, do ta padis taksisti në gjykatë. Sot, në dy raste për pak sa nuk më vrau.

- Mos u ngut zemër. T'i japim edhe një rast...

BARSOLETA

THËNIA E DITËS



Martohu me një arkeolog. Sa më shumë të mplakesh, aq më e bukur do t'i dukesh.
(Agatha Christie)